

VLERA

REVISTË PËR FAMILJE DHE SHOQËRI



*Urime
Muaji Ramazan!*



**FEJA NUK
ËSHTË DHUNË**

BOSTONI
qytet shenjtëror

WF-AID

NDIHMON KOSOVËN

**LUTJET GJATË
MUAJIT RAMAZAN**



SI E PËRJETOVA FIGURËN E MISINE KOKALARI

FQ 4



FEJA NUK ËSHTË DHUNË, ËSHTË PAQE

FQ 6



VEPRAT GJATË RAMAZANIT

FQ 26



25 PREMTIME NGA ALLAHU

FQ 34



ROGER WATERS NDIHMON PALESTINËN

FQ 42

KRYEREDAKTORE:

H.Ikballe Berisha Huduti

ikballebh@gmail.com

www.ikballebh.blogspot.com

Mob: +377 44 142 038

REDAKTORE:

Ardiana Ismaili

REDAKSIA:

Mr. Iris Robaj

Dr. Emine Goxhuli

Fehmi Maliqi

Zehra Huduti

Arlinda Hashani

Mr. Arbër Berisha

Dafina Berisha

Adelina Rama

DESIGN:

MM

ADRESA:

Lagjja Veternik pa nr.

Prishtinë 10.000 kosovo

E-mail: vlera.magazine@gmail.com

www.vlera.net

Botoi: Shtëpia Botuese

"Dielli Pas Reve"

044/043 509 700

Print: Roto Print

Tirazhi: 2000 copë

SPONSORED BY:

THE
WORLD
FEDERATION
OF KHOJA SHIA ITHNA-ASHERI MUSLIM COMMUNITIES



Në emër të Zotit Mëshiruesit Mëshirbërësit

*Ju urojmë të gjithë besimtarëve musliman Festën e Madhe të Agjërimit në muajin e Shenjtë të Ramazanit.
E përjetofshi e gëzofshi sot e për shumë mot.*

Muaji i Ramazanit është muaji më me vlera dhe më i bagatë. Ky muaj ku Zoti Fuqplotë i hap dyert e mëshirës së Tij për të gjithë njerëzit dhe fjala e Tij (Kur'ani), që është programi më i plotë udhëzues për lumturinë e njeriut, i'u zbrit profetit të madh Islamit në këtë muaj të bekuar. Prandaj muaji i Ramazanit është muaji më me vlera dhe më i bagatë. Ky muaji ku Zoti Fuqplotë i hap dyert e mëshirës së Tij për të gjithë njerëzit dhe fjala e Tij (Kur'ani), që është programi më i plotë udhëzues për lumturinë e njeriut, i'u zbrit profetit të madh Islamit në këtë muaj të bekuar.

*Të nderuar lexues të Revistës VLERA ! Kemi nderin të ju njoftojmë se revista Vlera si projekt ka filluar të përpilohet e më pas realizohet në muajin Ramazan dhe tani më u bënë katër vite që në këtë ramazan redaksia e jonë botoi numrin e 22-të të radhës. Ashtu sipë ju kemi premtuar dhe ne ju kemi nderuar në besë se **“VLERA” do të dëshmojë dhe manifestojë vlerat etiko-morale, tradicionale, religjioze dhe shoqërore, duke sendërtuar pozitën më të bukur dhe më të ndritur në shoqëri anë e mbanë botës shqipfolëse.***

Duke qenë në shoqërinë e këtyre vlerave, a ka zbukurim më të bukur kur në një familje shqiptare të shfletohet një revistë siç është “VLERA”. Kjo do t'iu sjellë në ambientin tuaj familjar harmoni, diskutim, njohuri të reja, motivim për punë të mira, bashkëpunim, qetësim shpirtëror, pra kjo do të fusë në familjet tuaja një sistem komplet të bukurisë së të jetuarit.

Identitetin dhe personalitetin e njeriut e të shoqërisë e formojnë vlerat humane, të përfituara nga infrastruktura shkencore dhe filozofike, kultura kombëtare regjionale dhe traditat e vendit. Andaj, çdo shoqëri, e cila dëshiron të formojë identitetin e vet të pavarur duhet të punojë në këtë drejtim që mos të lë anash vlerat kombëtare, Fetare dhe tradicionale.

Pa asnjë mëdyshje themi se revista VLERA ka forcë e vullnet që ta rikonstruktojë botën, duke avancuar civilizimin kulminant të bazuar në ligjet e Krijesit të Vërtetë për të mirën e femrës dhe familjes në përgjithësi.

Puna dhe ambiciet tona kanë bërë që revista VLERA të jetë e veçantë, e lexueshme, e kapshme për të gjitha moshat sepse kanë të bëjnë me tema që lidhen me besimin, edukimin, ngritjen shpirtërore dhe morale, familjen, femrën, si dhe tematika të fushave të ndryshme shoqërore.

Besojmë se do të jeni të kënaqur me punën tonë vetëdijësuse dhe dobiprurëse. Sygjerimet dhe mendimet tuaja i mirëpresim në adresën tonë elektronike vlera.magazine@gmail.com

Kryeredaktorja Ikballe Berisha Huduti



SI E KAM PËRJETUAR UNË FIGURËN E MUSINE KOKALARIT



PROF. ERMELINDA KASHA

Tema Të shqyrtosh në mënyrë kritike atë çka ishte kthyer në tabu, në pamje të parë të ngjan si një terezi e pashoq, dhe thua se a luhet me ato themele të brishta të letërsisë?

Këtë prekje në sedër, sot mendova ta ndaj mes jush, ku njeriu nuk mund të bëhet rob i asaj çka përjeton, por niset nga e vërteta. Sindromin e këtij fenomeni e kam vuajtur, ai kujtim i harruar, sot është sprovë për cilësitë e kësaj figure. Realitetet ndërmjet letërsisë dhe politikës janë kundërthënëse në shumë aspekte. Ky realitet tregon sesi



NJERIU NUK MUND TË
BËHET ROB I ASAJ ÇKA
PËRJETON, POR DUHET
NISET NGA E VËRTETA.

në të vërtetë në një periudhë kohore nuk ka qënë e mundur pavarësia e letërsisë.

Ishte viti 1990, ku në shkollë na grisën të gjitha materialet për Kadarenë. Në memorien time befas hera e parë që unë dëgjoj emrin Musine, e cilësuar si armike popullit, ku sipas parafolësve, Kadareja do ndiqte rrugën e Musinesë.

Një ditë, mësuesi i letërsisë na dha një temë hartimi e cila titullohej kështu: **“Nga hiri i një kulture të shuar filizon një kulturë tjetër”**

Me një sulm drejtuar të pavlerës, që poshtëron jetën e individit, një tingull i mprehtë dhe një sinjal alarmi më preku cakun e patoleruar të vetëdijes sime. Kur profesorin tim e pyeta se kush ishte


Musineja,- ai mu përgjigj: Një e keqe që i vjen njerëzimit bashkë me imperializmin, ku qëllimi sipas tij ishte asgjësimi i kësaj figure, në një kohë që intelektualë të tjerë, më thoshin se ishte gonxhja e parë që në një pjesë të botës u bë pranverë (kujtojmë këtu shkollimin në La Sa Pienca). Mos u çudisni, por “Tranzicioni i gjatë dhe me shumë probleme të mprehta në vendin tonë, ishte pasojë e lënies jashtë pushtetit të atyre që u përndoqën dhe u vranë gjatë regjimit komunist.

- Kam qënë gjimnaziste kur lexoja polemikat që ngjalli “Leonardo” në fillim të shekullit, lexoja raportet midis kulturës akademike e kulturës militante, apo erërat e reja që solli “La Critica” (kritika) e Benedetto Kroçes në rrethet e studimeve historiko-letrare, po emrin e Musinesë nuk e lexoja askund.


- Kjo fidanishte e tërë idesh kish filluar të më lindi, si një personalitet që kultivonte tendenca të reja.

- Më duhet të shfletoja për Musinenë kur u emërova si pedagoge,dhe kërkoja material për një konferencë ndërkombëtare në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë. Lexova mbi Arshi Pipën, Trifon Xhaxhikën i cili kish braktisur vijën e “realizmit socialist”, Astrit Delvina u pengua në vulgun e krijimtarisë, Bilal Xhaferri, Sejfulla Malëshova ku poezitë e tij u asgjësuan, lexova mbi Qamil Buxhelin, Fatos Arapin etj. Ndërkohë lexova edhe për një poet arbëresh në mos gaboj i 1917, Maria Antonio Braile, motra e një poeti arbëresh ku kish botuar vetëm një libër të vogël të titulluar “Këngë”, ku dhe ajo fliste për veten dhe kish pak a shumë një fat të ngjashëm me atë të Musinesë. Të gjitha këto emra ishin të përfshira në një revistë të vogël. Dhe befasi mendova, çdo të ndodhte sikur segmenti politik të mos ia kish prerë rrugën kësaj figure.

- Edhe Herman Hesse kish botuar një shkrim me titull : “Letër një komunisti”, ku citonte: Në asnjë mënyrë nuk besoj që komunizmi ka një përgjigje më të mirë mbi çështjet e mëdha të jetës sesa ndon-



ARSHI PIPA



FATOS ARAPI

jë mençuri më e hershme. Dhe këtu përmendte: Petro Marko si figura përjashtuese e censurës, Trebeshina, artisti kundër shtetit, Reshpja, alkimia e kulluar e verbit, Camaj- Antomodeli i realizmit socialist, Zef Zorba- ende fjetur e vdekur, ku thosh: “Ishin vitet ku ngjallehin polemika, ndërkohë përmendte dhe Musinenë”.

Po ato ditë lexoja edhe për Elyarin përfaqësesi i surrelizmit që ndau të njëjtën fat. Citoj: **Jetova i lodhur për vete dhe për të tjerë / Në emër të shpresës luftoj errësirën.**

- Për fat, profesioni që kam, ma plotësoi këtë prirje drejt majave. Edhe pse lexoja disa gazeta, u mundova ta fusja në program ku studentët merrnin informacione në lidhje me këtë figurë.

E vetmja ndjenjë e thellë, e hidhur që më ka ngehur, është mospërfshirja nëpër tekstet shkollore të etiklit parauniversitar.

Mbetemi te çështja se çka unë përjetova asaj kohe. Mjedisi që na rrethon luajti rol në formimin e njohjes së saj.Hapësira dhe koha shoqëroi veprimet e mija. Ndjenja më ritakoi në po atë vend, duke simbolizuar lëvizjet dhe veprimet konkrete që bëhen pjesë e kujtesës kolektive historike siç jeni edhe ju sot. E kujtoj këtu një shembull gjatë përjetimeve të mija personale ku një koleg po më tregonte detaje shumë të imta për Musinenë. Sigurisht këtu nuk kishim të bënim me harresën, por me izolimin në shpirt të rasteve fatkeqe të këtyre njerëzve, zbulimi i të cilave ma ripërtëriti këtë ndjenjë të rëndë sot. Sot mendja ime është e çliruar prej gjykimit të teorive nga më të ndryshme .

ERMELINDA KASHAH

Universiteti Eqrem Çabej

Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore

Gjirokastër.

Feja nuk është dhunë, dhuna nuk sjellë paqe!

“Kush mbytë një njeri pa të drejtë është njëjtë sikur do të kishte mbytë tërë njerëzimin. Dhe, kush shpëton një jetë do të ishte sikur të kishte shpëtuar gjithë njerëzimin.”

Maide 32



Ikbale Berisha Huduti

Kosova ime është në një kaos politik, Maqedonia gjithashtu, Shqipëria ashtu-kështu, duke u munduar të lundrojmë si një anije e lodhur në oqeanin europian.

Bota po bënë luftëra, gjenocid, gjakderdhje karshi njerëzve të pafajshëm, sulme të cilat çdo ditë e më shumë po ashpërsohen, po bëhen vdekjeprurëse, po marrin jetë të pafajshme, por këto, askush nuk i shikon e as nuk bën zë, bota hesht, dhe si pasojë çdo ditë vriten në mënyrë mizore shumë viktima. Sa i përket vrasjeve pa asnjë faj, Kur'ani i shenjtë na jep këtë mësim: **“Kush e vret një njeri pa të drejtë është njësoj sikur të ketë vrarë tërë njerëzimin. Dhe, kush shpëton një jetë është njësoj sikur të ketë shpëtuar gjithë njerëzimin”.**

Kur ndodhën aktet terroriste në Francë, dhe të gjithë sytë e botës ishin kthyer drejt Francës, mua më dhimbseshin shumë ato viktima të pafajshme. E gjithë bota u revoltua, investoi, harxhuan para e kohë duke u solidarizuar me

aktivitete, gjeste e forma të ndryshme. Mediat shprehnin keqardhje në mënyra e forma të ndryshme.

Ndërkaq, në vendet ku jetojnë muslimanët, si në Palestinë, Ukrainë, Burma, Libi, Irak, Jemen, Siri, së fundmi edhe në Turqi, ku vazhdimisht ushtrohet dhunë, gjenocid dhe çdo ditë nëpër këto vende rrjedhin lumenj gjaku, për këto vende shumë pak bëhet gjë, dhe askush nga perëndimorët nuk e ngre zërin, ngase muslimanët ndoshta nuk janë si ata, as në fe as në traditë, as në kulturë as në politikë, pra askush nuk e çan kokën, nuk duan të shohin, dhe kjo jo që janë të verbër por i pengon drita e së vërtetës së hidhur që vetë ata e kanë krijuar, dhe asnjëri nuk ndjen dhimbje sepse ato vende nuk janë Franca e Europës.

Siç po shihet, luftërat që po bëhen në Lindje, nuk po ndodhin për të luftuar terrorizimin, por për të marrë pronësinë e naftës në zonat strategjike. Luftërat po bëhen për pushtet duke përdorur mashën sektare fetare të pavetëdijshme, e cila po e zvarrit zjarrin nga njëri shtet musliman në tjetrin. Siç duket në këto vende ka vdekur politika, ngase feja pa politikë është si trupi pa kokë.

Fenë të cilën tani për tani në këto vende të turbullta muslimane, mendojnë se e mbajnë në duar radikalët dhe diktatorët, mos të mendojnë se kjo mund të quhet fe. Kjo nuk është fe, sepse në fe nuk ka diktaturë, në fe radikalizmi është i mirë vetëm deri në atë masë kur mbahemi në rrënjët e çiltra të Kur'anit e jo në hadithet e thëniet e fetarëve të padenjës.

Bota në përgjithësi, e bota muslimane në veçanti po rrezikohet nga konfliktet e brendshme fetare të cilat po udhëhiqen nga grupe radikale, të cilat haptas po predikojnë një Islam ndryshe, karshi atij Islamit burimor nga Shtëpia e Shpalljes, që kanë predikuar gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë të brezit të Profetit Muhammed –paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij. Tashmë te këta fetarë radikalë feja u bë përslesh, u bë e gërditshme, e frikshme për ata që nuk kanë pasur mundësi të njihen me fenë e vërtetë islame. Tashmë te këto grupe radikale dhe te liderët diktatorë edhe ritualet e tyre janë më ndryshe, ku kurrrë nëpër xhamitë tona nuk është është dëgjuar me brohori shprehja “Amin” e sures El-Fatiha si “Amen” i kishave të krishtera, ndërsa toleranca fetare po bëhet e padurueshme.

Tashmë kjo **“fe radikale e diktatoriale”** nuk po jep fruta të ëmbla, por ajo po shkatërron kulmin e çdo familje të pavetëdijshme e me statut të ulët social. Tani diktatorët dhe radikalët kanë harruar se çfarë është kompromisi, bashkëbisedimet dhe marrëveshjet në emër të Zotit, ngase i ka zaptuar ndjenja e pushtetit të dreqosur.

Neve që po shohim atë çfarë ju po bëni, po na dhemb më shumë, ngase jemi ngujuar në vendet tona europiane, dhe neve që kemi ndjenja humane po na bllokohet fryma nga shikimet që po vërejmë në rrjetet sociale. Neve nuk na mbetet gjë tjetër vetëm që të besojmë në atë që Zoti na ka premtuar, e Allahu na ka thënë se: **“Ai (Allahu) nuk e shkel premtimin e Vet” (Ez-Zumer 20), dhe se “Premtimi i Allahut është i vërtetë; Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.” (Lukman, 31: 9)**

Prandaj, këto premtime më japin fuqi dhe guxim, se ju që i kurdisni këto kurthe, gjakderdhje të pafajshme, mizori, krime e trishtime, nuk jeni forcë, sepse Zoti ka thënë se forcat e kriminelëve, njerëzve të lig -

“nuk do t’ju bëjnë asnjë dobi, sado të jenë të shumta në numër, sepse Allahu është me besimtarët.” (El-Enfal, 19)

Për hir të gjakderdhjeve të pafajshme, duhet të ngrihem i kundër terrorizmit, me një postim, një fjalë, një dhimbje, një pikë loti, dhe ky të jetë ushqimi i ditës për ty. Nëse je kundër të keqes, ti je mik me të mirën, por nëse nuk ke guxim që të ngresh zërin tënd kundër së keqes, të jesh i sigurt se ti po ndihmon të keqin, të ligun dhe të jesh i sigurt që edhe ti je pjesë e asaj gjakderdhje të pafajshme.

Një fjalë e jotja në rrjetet sociale mund të shpëtojë një gjakderdhje fëmije. Një diskutim yt në opinion, në konferenca, seminare e tubime të vogla apo të mëdha, do të shpëtojë me qindra gjakderdhje të pafajshme. Një pikë loti në shpirt do t’i japë jetë miliona shpirtrave që kanë nevojë për gjak.

Prandaj ngrihu, mos u frikëso nga e vërteta, zgjatja dorën të shtypurit. Ejani të bëhemi të gjithë kundër terrorit dhe dhunës që janë pjellë e shpirtrave të zinj, e mendjeve të kufizuara në besim të gabuar.

Mos iu frikëso pozitës, emrit, e famës tënde se pozita që ta jep Zoti është më e lavdishme se ajo që ke. Është e vërtetë që po fole për dhunën që iu bëhet njerëzve të dobët, po fole për të vërtetën që e kanë të “fortët” në pushtet, ti do të jesh i anashkaluar, i përfolur, i sulmuar, i përbuzur, i shpifur, i neglizhuar nga të tjerët por një gjë duhet ta dini se Zoti ka premtuar:

“Vërtet, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Zoti i tyre do t’i udhëzojë në rrugë të drejtë.” (Junus, 10: 9)

Prandaj mos hezitoni, mos u molepsni nga padrejtësitë, mos nguroni dhe mos u frikësoni nga thënia e së vërtetës kundër dhunës ndaj të dobët, sepse Zoti ka premtuar:

“Se për ata që besojnë dhe nuk e molepsin besimin e tyre me padrejtësi, pikërisht atyre u takon siguria dhe ata janë të udhëzuar. (El-En’am, 6: 82)

Mos u frikëso kur të thuash të drejtën, por beso në atë që të ka premtuar Zoti e ajo është:

“Allahu, në të vërtetë, i mbron besimtarët. Ai nuk i do tradhtarët mohues.” (El-Haxh, 22:38)

Prandaj, beso fuqishëm në premtimin dhe këshillën e Allahut, sepse Ai është i Plotfuqishëm, ai nuk ka rival, dhe premtimin e Tij patjetër që e ka zbatuar deri sot dhe do ta zbatojë deri në Ditën e Kiametit, prandaj mbaje në mend këtë këshillë nga Ai dhe mos u bëj nga ata për të cilët Allahu thotë:

“Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë një jetë të mjeruar...” (Ta-Ha, 20:124)

Ndërsa për ty që i beson të mirës, të vërtetës dhe të drejtës, Zoti të ka dhënë sihariq, prandaj duhet të gëzohesh kur Ai thotë:

“Për sa u përket atyre që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, ata Zoti i tyre do t’i pranojë në mëshirën e Vet. Kjo është fitorja e lavdishme!” (El-Xhathije, 45:30)

“Sa për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, sigurisht që Ne nuk do t’ua humbim shpërblimin punëmirëve.” (El-Kehf, 18:30)

Prandaj, mos t’ju mashtrojë pozita, lakmia, pasuria, luksi, nderi i rrejshëm, fisnikëria e pagënë por e etiketuar, por mbështetu tek Zoti i Vërtetë, tek drejtësia e Tij dhe askush nuk do të ketë pushtet ndaj teje dhe ti do të jesh nga fisnikët, të drejtët dhe udhëheqësit e vërtetë, sepse:

“Në të vërtetë, nuk ka kurrfarë pushteti mbi ata që besojnë dhe mbështeten tek Zoti i tyre.”
(En-Nahl, 16:99)

O njeri i së drejtës, o njeri i heshtur e naiv, jo që nuk kupton por mediat aq shumë të kanë mbuluar me fjalë të kota sa që tani më nuk je në gjendje të kuptosh edhe gjuhën tënde shqipe. Shqipja e nënës është përzier me fjalë të gënjeshtra dhe humbi esencën e fjalës së qëndrueshme. Të këshilloj që mos ta humbësh shpresën, por kërko nga i madhi Zot të jesh më vigjilent e të mos jesh i heshtur e naiv, por të flasësh fjalë të qëndrueshme për veten, familjen dhe shoqërinë, sepse: **“Allahu i forcon besimtarët me fjalë të qëndrueshme në këtë botë dhe në botën tjetër, kurse keqbërësit i çon në humbje; Allahu bën ç’të dojë.”** (Ibrahim, 14:27)

Ndjej dhimbje për të gjitha këto trazira dhe gjakderdhje të pafajshme, gjithashtu ndjej dhimbje edhe për vendin tim, ku ka kaos të madh politik, ku papunësia ka shkuar deri në qiell, ku po ndodh një emigrim i pakufishëm i të rinjve, ku ka korrupsion, pabarazi, hipokrizi, sjellje amoralë në krah të modernizmit. Po jetojmë në një botë të verbër, ku qorri është mbret. Zoti i bekoftë të gjitha vendet e prekura nga aq shumë luftëra të pakuptimta dhe plot me kaos. Zoti pastë mëshirë për ne popullin shqiptar që po jetojmë si një anije e vogël në oqeanin e madh të Europës. Prandaj, këshilla ime për të gjithë është:

“Vërtet që jemi një anije e cila nuk mund të jetojë pa detin e bujshëm e të madh. Jemi një anije që herë përballemi me valë të mëdha e herë lundrojmë të qetë në oqeanin europian, herë na kaplojnë baticat e herë zbaticat, por duhet të kemi kujdes e të mos e dashurojmë shumë oqeanin, sepse anija pa oqean nuk ka jetë, por nëse e dashurojmë shumë ajo do të fundoset në fund të saj.”

Dhuna nuk sjell paqe! Mjaftë me dhunë!



POLIGAMIA

nuk është pjesë e mësimave Islame



NURUL FITRI RAMADHANI
THE JAKARTA POST

Duke iu përgjigjur polemikave të gjata për poligaminë në një kongres kombëtar tre-ditor gjatë të cilit qindra klerike femra nga mbarë shteti Indonezian diskutuan sfidat me të cilat përballen gratë indoneziane.

Ato theksuan se praktika e poligamisë nuk është pjesë e mësimave islame.

Sipas Siti Ruhaini Dzuhayatin, e cila përfaqëson Indonezinë në Organizatën e Bashkëpunimit Islamik (OIC), sjell në pah Islami kurrë nuk prezantoi konceptin për të pasur bashkëshort të shumëfishtë në të njëjtën kohë.

"Poligamia ka ekzistuar qysh prej epokës së xhahiletit. Në atë kohë, burrat u lejuan të kishin një numër të pakufizuar të grave" -tha Siti, duke iu referuar epokës së injorancës "në historinë e Lindjes së Mesme para ardhjes së Islamit.

"Kur erdhi Islami, ajo humanizoi praktikën duke kufizuar numrin [e grave që një njeri mund ta merrte], " shtoi ajo.


Shumë muslimanë konservatorë ende pretendojnë se poligamia është e lejuar në mësimin Islam. Megjithatë, qeveria mbështet parimin e monogamisë me nenin 3 të ligjit, i cili përcakton se një burrë lejohet të ketë vetëm një grua.

Kongresi i parë i klerikëve muslimanë të Indonezisë synon të forcojë rolet e grave

Ligji lejon që burrat të marrin një grua të dytë nën kushte të caktuara, siç janë rastet kur gruaja e tij e parë vuan nga një sëmundje e rëndë ose nuk është në gjendje të lindë një fëmijë.

"Duhet të mësojmë se vetë Kur'ani nxit monogaminë; Thuhet se nëse burrat nuk janë në gjendje t'i trajtojnë gratë në mënyrë të drejtë, atëherë ata duhet të kenë vetëm një grua. Pra, kërkesa [për marrjen e një gruaje të dytë] është e rreptë dhe kjo për shkak se praktika mund të çojë në dhunë dhe padrejtësi ndaj grave ", tha kleriku Nur Rofiah i Kolegjit Kur'anor të Xhakartës.

Përgaditi: Valdrin Jashari



Gratë me vecanti

FATIMJA

ËSHTË FATIME.

Hazreti Fatimja kështu jetoi dhe kështu vdiq

Pas vdekjes së saj, ajo filloi një jetë të re në histori. Ajo paraqitet në fytyrat e të gjithëve që janë të shtypur. Të gjithë ata që torturohen, që vuajnë, e që uzurpohen e kanë si shëmbëlltysë Hazreti Fatimenë.

Përkujtimi i Fatimesë u zhvillua me dashuri, emocione e besim të plotë në mesin e burrave dhe të grave, të cilët gjatë historisë islame luftuan për liri e pavarësi. Zëri i tyre u ngrit për shkak të zemrave të tyre të plagosur! Për këtë shkak Fatimeja u bë burim i inspirimit për liri, për drejtësi dhe për rezistim kundër presionit, ashpërsisë, krimit e diskriminimit të masave të privuara.

Është shumë vështirë të bisedohet rreth personalitetit të Fatimesë. Fatimja është ashtu siç kërkon Islami prej gruas në jetë! Koncepti i fytyrës së saj është vizatuar nga vetë Pejgamberi s.a.a. Pejgamberi e ka mësuar si t'u përballojë vështirësitë, varfërisë e rezistencës, si të kuptojë thellë dhe si të jetë humane.

Ajo është simbol i të gjithave femrave në jetën si gruas; Simbol i vajzës kur takohet me babain, Simbol i gruas kur takohet me burrin. Simbol i nënës kur takohet me fëmijët dhe simbol i përgjegjësisë në shoqëri.

Ajo vetvetiu është udhëheqëse. Ajo është shëmbëlltysa më e bukur për çdo grua që dëshiron ta mbrojë personalitetin e vet. Ajo e mëson gruan se si të bëjë përpjekje në mënyrë permanente e të rezistojë në dy fronte, brenda dhe jashtë, në shtëpinë babait dhe të burrit, në shoqëri, në mendime, sjellje dhe në jetë.

Unë s'di ç'të them. Fjalët janë të pakta për ta thënë atë që dua!

Ajo që më impresionon më së shumti është shpirtgjerësia e saj. Ajo është bashkudhëtare, hap pas hapi fluturon bashkë me shpirtin e Aliut.

Ajo nuk ka qenë vetëm bashkëshortore e Aliut. Aliu e konsideronte si pjesëmarrëse në të gjithë vuajtjet dhe në gjithë dëshirat e tij. Ajo ishte prehje e tij! Ajo i dëgjonte fshehtësitë e tij. Ajo ishte shoqëruesja e vetme në vetmi.

Për këtë shkak Aliu kishte një respekt të posaçëm ndaj saj dhe ndaj fëmijëve të saj. Pas Fatimesë Aliu është martuar me gra tjera dhe ka patur fëmijë me to, por që në fillim i ka ndarë fëmijët e Fatimes prej fëmijëve të tjerë. Fëmijët tjerë quheshin “Fëmijët e Aliut”, kurse të parët “Fëmijët e Fatimes”. Nuk është për t'u habitur, ngase fëmijët e Fatimesë i ngjani nënës.

Ne gjithashtu vërejtëm se Pejgamberi kishte një qëndrim të posaçëm ndaj saj. Ai më së tepërmi e disiplinonte Fatimenë. Ai mbështetej vetëm në të. Që nga mosha e re, ajo kishte pranuar thirrjen e madhëruar!

S'di se ç'të flas rreth saj! Më kujtohen fjalët e një shkrimtari francez i cili në një konferencë rreth Merjemes , thotë:” Rreth 1700 vjet është biseduar rreth Merjemes; rreth 1700 vjet filozofët dhe mendimtarët e Lindjes e të Perëndimit kanë folur rreth vlerave të Merjemes; rreth 1700 vjet poetët kanë thurur poezi rreth Merjemes; rreth 1700 vjet piktorët kanë vizatuar piktura rreth Merjemes; por asnjëherë nuk kanë patur mundësin që të pershkuajnë gjendjen e saj si nënë e Krishtit”.

Edhe unë dëshirojë të fillojë në këtë mënyrë me Fatimenë. Dëshiroja të them:”Fatimja është vajza e Hadixhes; së njohur”. Ndjeva se ajo nuk është Fatimeja. Dëshiroja të them: **”Fatimja është vajza e Muhamedit a.s.”** Ndjeva se ajo nuk është Fatimeja. Dëshiroja të them: **”Fatimja është bashkëshortja e Aliut”**. Ndjeva se ajo nuk është Fatimeja. Dëshiroja të them: ”Fatimja është nëna e Hasanit dhe Husejnit”. Ndjeva se ajo nuk është Fatimeja. Dëshiroj të them:”- Fatimja është nëna e Zejnebes” Sërish ndjeva se ajo nuk është Fatimeja”.

Po, të gjitha këto janë të vërteta por asnjëra nga këto nuk është Fatimeja.

FATIMEJA

ËSHTË FATIME.



ËSHTË I PARI QË KA LINDUR NË XHAMI DHE I PARI QË ËSHTË VRARË NË XHAMI

Imami Aliu Prijësi i Besimtarëve ra shehid, u martirizuar në vitin 20 Hixhri në muajin Ramazan. U plagos në natën e 19-të ndërsa dha shehadetin në natën e 21-të – Natën e Xhuma.

Shpirti i tij i pastër është i përhershëm dhe do të mbetet i gjallë në mesin e popujve duke jetuar me dituritë e tij dhe anën njerëzore të tij. Duke dhënë kontributin e tij, i cili nuk shuhet derisa të ekzistojnë qiejt dhe toka: “Kurrësi të mos mendoni se janë të vdekur ata që ranë dëshmorë në rrugën e Allahut. Përkundrazi, ata janë të gjallë duke u ushqyer te Zoti i tyre”. (Sure Al-Imran / ajeti 169.)

Komploti për vrasjen e tij

Historianët kanë rënë dakord se tre burra prej havarixhëve kanë komplotuar në vrasjen e Aliut ibn Ebi Talibit dhe Muavijes ibn Ebi Sufjanit dhe Amr ibn Asin. Sipas mendimit të tyre ata janë thelbi i ngatërresave që ndodhnin në mesin e myslimanëve dhe me këtë rast ata ia hapnin rrugën ymetit që të zgjidhnin imamin, që e kënaqnin feja dhe dynjaja e tij.

Aburrahman ibn Mulxhem ishte banor i Egjiptit, ndërsa dajallarët i kishte në Irak, ai mori përsipër vrasjen e imam Aliut dhe e kreu detyrën e tij me sukses. Kurse **el-Burku**, emri i të cilit ishte **Haxhaxh ibn Abullah** ishte nga një

fis në Basra, ai mori përsipër vrasjen e Muavijes por nuk ia doli dot, sepse ai për fat të mirë të Muavijes e goditi me anën e mbrojtur të shpatës dhe Muavija u kurua dhe shpëtoi. **Zadhuvih**, i pari i beni Anber quhej Amru ibn Bekri u nis përpara për të vrarë Amru ibn Asin, i cili në atë kohë ishte mëkëmbës i Egjiptit nga ana e Muavijes. Mirëpo ibn Asi u vonua për të falur namazin dhe kështu që atë e zëvendësoi shefi i policisë së tij (Kharixhe ibn Hudhafetu el Uduij) atë e vrau Kharixhen dhe ibn Asi shpëtoi.

Kjo pra është pjesa që historianët dhe transmetuesit e lajmeve kanë rënë dakord, por ai që e përqendron shikimin e tij në kronologjinë e ngjarjeve të komplotit do t'i bëhet e qartë, pa dyshim se komplotuesit e vërtetë janë: Muavije ibn Ebi Sufjani dhe Amru ibn Asi, Esh'athu ibn Kajsi. Kurse ekzekutori i vetëm është Aburrahman ibn Mulxhem me ndihmën e Esh'ath ibn Kajsiit, i cili është parë gjatë ngjarjes duke e shtyrë ibn Mulxhemin që të nxitonte dhe i thoshte atij: **Nxito, nxito, mbaroje punën tënde se u zbardh dita dhe pa dyshim se komploti nuk synonte asnjë njeri tjetër, veç Aliut ibn Ebi Talibit (paqja qoftë mbi të!).**

Historia e Vrasjes së Muaviut dhe Amër Asit – teatër i vërtet.

Sa i përket historisë së vrasjes së Muavijes dhe Amru ibn Asit, ajo është një teatër që Muavija dhe ibn Asi në Siri e kanë luajtur mirë pjesën. Me mashtrimin e saj të tregojë kujdesin e Muavijes për dërgimin e disa shokëve të tij në Kufe, para kohës së zbatimit të komplotit, me qëllim që të përhapnin lajmin e vrasjes së tij në kohën e përshtatshme. Viktimë e komplotit të kontrolluar ra Kharixhe ibn Hadhafa dhe dy burrave të tjerë të mashtruar bashkë me ato të dy, kurse tradhtari Esh'ath ibn Kajsin nuk e mori në dorëzim shpërblimin e pjesëmarrjes së tij.

Komplot të cilën Muavija e sprovoi duke i ngjallur shpresë, që është të qenit mëkëmbës i Kufes, sepse sprova e vdekjes e mori atë pak ditë pas vdekjes së Imamit. Prijësi i besimtarëve e deklaroi vdekjen e tij pak para vrasjes së tij në ditët e tij të fundit. Kur Imami po deklaronte vdekjen e tij, përsëriste shpesh duke thënë: **Çfarë e pengon të fortin tuaj që të lyejë këtë dhe këtë, e kishte fjalën për mjekrën e tij me gjakun e kokës së tij.** Mes'udi ka thënë: Me të vërtetë Aliu nuk fjeti atë natë, por vazhdonte të ecte mes dhomës dhe korridorit duke thënë: **“Pasha Zotin as nuk kam gënjer dhe as nuk jam mashtruar, nuk ka asnjë dyshim se ajo është nata që më është premtuar.”** E sapo doli, një rosë që ishte e fëmijëve bërtiti dhe bashkë me ta bërtitën një pjesë e atyre që ishin në shtëpi dhe tha ai (Paqja qoftë mbi të!) **“lëri ato se janë në vajtim”.**

Profeti Muhamed s.a.a tha: “Mallkoi ata”

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) i thotë djalit të tij, Hasanit: “Kam parë në ëndërr të Dërguarin e Allahut (paqja qoftë mbi të dhe Familjen e tij) dhe unë i thashë: O i Dërguari i Allahut! Sa shumë shpirtligësi dhe urrejtje më ka rënë të takoj ndër ithtarët e tu!? Ai ma ktheu: “Mallkoi!” mirëpo unë i thashë: “Të m'i zëvendësojë mua Allahu me më të mirë se ata, kurse mua të më zëvendësojë për ata me një më të mirë se unë!”

Vrasja e Imamit (Paqja qoftë mbi të!) Nuk ka asnjë kontradiktë se ai (Paqja qoftë mbi të!) është vrarë në muajin e Ramazanit, në vitin dyzet të hixhretit. Mirëpo në përcaktimin e ditës ka shumë kontradikta, sepse orvatet mes datave (11 dhe 21) dhe se transmetimet më të përhapura thonë se ai është vrarë natën e (17) ose (19) ose (21). Mirëpo, ajo që është më tepër e fiksuar është transmetimi i imamëve të Ehli Bejtit që thotë se ai është goditur natën e të mërkurës, ditën e nëntëmbëdhjetë të Ramazanit dhe ka ndërruar jetë natën e njëzet e një (natën e xhuma). Mes transmetuesve ka pasur kontradikta se ibn Mulxhemi e ka goditur kur ai ka qenë brenda në xhami apo para se të hynte? Kush e ka falur namazin me myslimanët, imami ka pas lënë zëvendës apo e ka falur ai vetë? Ibn Abdul Berri në librin El Istiabu dhe ibn Ethiri në librin el Kamilu kanë thënë se ai është goditur gjatë faljes së namazit, atë e pasoi Xha'de ibn Hubejre el Makhzumi, i cili ishte djali i motrës së tij Umami Hani.

Amaneti Human i Imamit para Shehadetit

Amaneti i Imamit për djemtë, familjarët dhe për të gjithë myslimanët Kur ibn Mulxhemi e goditi atë, rreth tij u mbledhën djemtë dhe familjarët në mënyrë të veçantë shokët e tij, ai u la atyre një amanet. Në fjalën e tij specifikoi djemtë e tij Hasanin dhe Hysejnin dhe tha:

“Ju këshilloj t'i jepeni Zotit e të mos i lakmoni kënaqësitë e kësaj bote, edhe sikur vetë ajo t'ju rendi pas. Të mos ju vijë keq, kur ju mohohet gjë e saj. Flisni të vërtetën e veproni në mënyrë të tillë, që të prisni shpërblim. Të jeni armiq të shtypësve dhe ndihmës të të shtypurve. Këshilloj që ju dhe gjithë fëmijët e mi e anëtarët e familjes time, si dhe këdo tjetër, të cilit mund t'i bien në dorë shkrimet e mia, që të keni frikë prej Zotit. T'i mbani parasysh punët tuaja dhe të mbani raporte të mira me të tjerët, sepse kam dëgjuar gjyshin tuaj, që thoshte: “Sheshimi i mosmarrëveshjeve me njëri-tjetrin është më i mirë se lutjet

dhe agjërimi”. Mbani parasysh Zotin në sjelljet me jetimët dhe mos i lini të vuanjë nga uria e të rrënohen nën sytë tuaj. Mbani parasysh Zotin në marrëdhëniet me fqinjët tuaj, sepse Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) këshillohej me ta. Ai na nxiste e këshillonte, ne në të mirë të tyre, aq sa mendonim mos u linte pjesë në trashëgimi. Mbani parasysh Zotin në çështjet e Kur’anit. Askush nuk duhet t’jua kalojë në veprimin mbi bazën e tij. Mbani parasysh Zotin në punët e namazit, sepse namazi është shtyllë për fenë tuaj. Mbani parasysh Zotin në punët e shtëpisë së Tij, Qabes në Mekë si dhe të xhamisë në përgjithësi. Mos e braktisni sa të jeni gjallë, se nuk do t’ju kursejnë, po ta braktisni. Mbani parasysh Zotin në punët e xhihadit, duke përdorur në rrugën e Tij pasurinë, jetën dhe gjuhën tuaj. Nderojeni farefisninë dhe shpenzoni për të tjerët. Mos u bëni të huaj e mos i prishni lidhjet me njëri-tjetrin. Mos hiqni dorë nga urdhërimi në të mirë dhe ndalimin e së keqes, ndryshe do ju mund djallëzia dhe Zoti nuk do t’jua vërë më veshin, kur të doni t’i kërkon. O bij të Abdul Mutalibit, mos derdhni gjak myslimani duke u përligjur me vrasjen e imam Aliut. Hapni sytë: Mos vrisni për llogari time, përveçse atë që vrau. Prisni sa të vdes nga goditja që më ka dhënë vrasësi. Vetëm atëherë mund t’ia merrni jetën, por vetëm me një të goditur, mos e torturoni e mos ia prisni gjymtyrët, se kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), që thoshte: “Mos i prisni duart e këmbët, edhe sikur të jenë të një qeni të tërbuar”.

Medineja u la me lot Ajshja rrefehet para varrit të Pejgamberit Muhamed s.a.a

Kur imami (Paqja qoftë mbi të!) shkoi afër Zotit të tij, në Medinen e ndriçuar erdhi për të dhënë lajmin e vdekjes së tij, Kulthum ibn Amri. Lajmi i vdekjes së tij ishte i ngjashme me lajmin e vdekjes së të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) nga të qarat e të gjithëve, burra e gra dhe ata që ulërinin nga hidhërimi. Derisa njerëzit u qetësuan nga të qarat një grup shokësh të të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) thanë: “Ejani të shkojmë tek Aisheja, bashkëshortja e Pejgamberit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Të shikojmë merrzinë e saj për djalin e xhaxhait të të Dërguarit të Allahut dhe kur ata i morën leje asaj për të hyrë, panë se lajmi kishte shkuar tek ajo dhe se ishte në një dëshpërim të thellë, saqë nuk po qetësohej dot nga të qarat dhe vajtimi.

Të nesërmen ajo shkoi tek varri i të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe nuk mbeti asnjë nga xhamia pa e mirëpritur dhe duke e përshëndetur me selam. Ndërsa ajo nuk e kthente selamin, nuk përgjigjej dhe nuk fliste as edhe një fjalë prej lotëve dhe të qarët e tepërt. E mbytur në lotët e saj dhe e hidhëruar njerëzit qëndronin prapa saj, derisa iu afrua dhomës u ul në pragun e derës dhe tha: “Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi ty, o Pejgamberi i udhëzimit, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi ty, o babai i Kasemit, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi ty, o i Dërguari i Allahut dhe mbi shokët e tu. O i Dërguari i Allahut, unë po të lajmëroj për vdekjen e të dashurit tënd më të nderuar tek ti, duke të kujtuar ty për një nga amanetet e tua më fisnike për ty është vlarë, për Zotin, i dashuri yt i zgjedhur dhe shoku yt më besnik është vlarë, për Zotin ai që ti e martove me gruan më të mirë në faqen e dheut. Për Zotin, është vlarë ai që të besoi ty dhe të dha besën, kurse unë po qaj sikur të kem humbur djalin tim. Çdokush ka qarë me shumë lot dhe sikur ty të zbulohet dheu, të ngrihesh nga varri do të thoshe se është vlarë njeriu më bujar në mesin tuaj dhe njeriu më i nderuar dhe fisnik ndër jush.”

Fundi i udhëtimit – Proffesor Ukabi

Kështu pra Imami i devotshëm ra dëshmor në sabahun e ditës së xhuma, kur ai ishte duke bërë sexhde për Allahun xh. sh. Kështu ishte fundi i jetës së tij, ashtu siç e nisi, kur nëna e tij e pastër e lindi ditën e xhuma në shtëpinë e Qabes, duke rënë në tokë në sexhde për Allahun e Lartësuar. Kjo është një mirësi që askush para tij nuk e ka marrë dhe askush pas tij nuk do ta ketë.

Profesor Ukadi ka thënë:

“Imam Aliu ka dalë në këtë dynja dhe shehadeti (fjala e dëshmisë) ka qenë e shkruar në ballin e tij. Iku nga kjo dynja ku shehadeti ishte i shkruar në atë ballë me goditjen e një shpate, kurse fotografia e tij përmbledhëse nuk është e vështirë për ndonjë përshkrues e as për dikë që ka shikim ngulmues. Ajo është fotografia e luftëtarit në rrugë të Allahut me dorën e tij, zemrën dhe mendjen e tij ose fotoja e dëshmorit. “Ai thotë: Cili fund është i ngjashëm me këtë dëshmor të përshkruar me këtë përfundim. Pasi ai ka lindur në Qabe, siç e mësuam është goditur në xhami, siç e mësuam, pra cili fillim dhe fund është më i ngjashëm me jetën mes atyre të dyjave se sa ai fillim dhe ai përfundim.”

Imamin e kanë falënderuar trashëgimtarët e tij me qindra poezi gjatë katërmëdhjetë shekujsh në gjuhë të ndryshme. Qindra poetë në shekujt që do të vijnë do të vazhdojnë ta lavdërojnë dhe ta nderojnë atë derisa të vijë kijameti, sepse ai është shembulli më i lartë, pas Pejgamberit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) për njeriun e përsosur i cili shëmbëllet në të gjitha cilësitë e tij.



SOHBET

MJAFTON TË SHOHËSH KODRËN DHE POZITËN E SAJ

MAHMUT DIPSAR
MAHMUT XHAFCË



E ju mos rreshtni edhe më tej... (duke thënë) ka lindur në Mekke, ndërsa ka vdekur në Medine. Ç'është me ju? Hiqni dorë nga këto... meqë mendja juaj ende nuk është në gjendje ta kuptoj këtë, ta kuptoj Ashkun, aq më pak që nga Gonuli të ketë qasje në shfaqje, në të vërtetën.

E dimë se për ju jemi të çuditshëm, ndoshta edhe jeni të hidhëruar, por ç'të thoni tjetër, nuk kemi si t'ia bëjmë ndryshe, kështu na e kanë transmetuar... mos na e mvëshni dinakërinë, nuk jemi ne kundër hoxhëve, e gjithë kjo është detyrë e tyre t'ia përcjellin njerëzve, e jo e jona... pse këtë e heshtni, ndoshta iu përshtatet që ne ta bëjmë falas punën e tyre.

Ne nuk iu ftojmë juve, sikur Nuhu a.s. që e ftonte popullin e tij, e që me të njëjtën masë të na ktheni... Neve kjo na tërheq dhe për këtë jemi këtu, me qëllim që edhe ju ta kuptoni njohjen e pasardhësve të të Dërguarit të Allahut s.a.a.... njohurinë e atyre që nga themeli e ndryshojnë prezantimin për fenë... që per-

siasin dhe i rrënojnë kufizimet ... që të mos mashtroheni më, që mos t'iu mashtroj kurrfarë marketing dhe propagandë.

Adabet e kryerjes së obligimeve ndaj të "mëdhenjëve" janë nevojë e juaja, ndërkaq deklaratat e juaja entuziaste me rastin e takimit dhe të shoqërimit me ta janë reflektim i brendisë tuaj e jo shfaqje dhe meritë e tyre... e kush rebelohet kundër kësaj ai shpallet armik i së vërtetës dhe hynë në luftë me Allahun.

E tani ejani, deri sa ende jeni me ne, na sjellni nga një çaj..., që ju, që deri më tani ende nuk e keni ndjerë ëmbëlsinë e krijimit të ri..., që ju, për shkak të të kuptuarit të dobët dhe keqkuptimit që nesër të na pështyni dhe të na përfolni kudo që të jeni, meqë janë të rrallë ata që i mëson të gjuajnë, e që më vonë të mos bëhesh target i tyre.

Po, është thënë: – Ai i cili më sheh (në ëndërr) ai më ka parë me të vërtetë... pak më parë biseduam për këtë, por çfarë të Dërguari po

kërkoni? Si do ta besoni? Mbase në xhep e keni figurën e tij? ...aha! Nuk ka ndryshuar aspak.. thoni të vërtetën... mbase nuk është fare i ndryshëm nga ajo që tani po shohim... e keni përshkrimin në libra...se ishte me një shtat mesatar... vija të bukura të fytyrës... sy të zi... dikush thotë edhe ndryshe... po nuk është çështja te kjo, iu lumtë edhe juve edhe atyre që i kanë shkruar ato libra...

Por ta dini dhe të jeni të bindur se Allahu xh.sh, nuk ka ndryshuar, e as që ka ndryshuar modeli i njeriut që nga koha e Ademit... ndërkaq tani më dihet se llojet nuk janë në gjendje të evoluojnë, ashtu sikur mendojnë shumë njerëz, meqë secili lloj është i pavarur dhe me kualitete të ndryshme nga lloji tjetër... ndërkaq genet e paracaktuara janë gjenet e njëjta të të gjitha krijesave, secili prej tyre ushtron detyrën e vet....

Gjithashtu, vetëdija – Ruh-i nuk mund të evoluoj nga materia, meqë janë shumë më i hershme se materia... evoluojnë, piquen dhe e marrin mjaltën e tyre nga drita e Tij, sikur frutat e pemëve të ekspozuara në Diell...

Dëgjoni, nëse me të vërtetë dëshironi që ta shihni Atë, mos e kërkoni në imazhin e njerëzve dhe fqinjëve të njohur për ju, kërkoni thelbin e Tij, kërkoni thelbin e imazheve me të cilat takoheni, kërkoni Ashkun e forcës iniciale të të gjitha formave dhe imazheve... bëhuni rob i vërtetë i Allahut... sepse i Dashuri secilit ia jep të drejtat e veta, ndërkohë që e kërkuara është më e ëmbël nga e fituara....

Po, po, deri sa jeni me Të dhe sakrifikoni për Të, kërkoni, përpiquuni ta shihni, që të shiheni,... e jo kam lexuar atë apo këtë,... kësh-tu tha ai, e diçka tjetër tha tjetri... Hiqni dorë nga imitimi dhe ndaluni të na përndjekin dhe të jetoni në pritje, sa për të parë ndonjë keramet...

Nuk ka, ne nuk dyshojmë, përveç Nurit nuk kemi ne keramete, kerameti ynë në të vërtetë është kjo çfarë jeni duke dëgjuar. Nuk jemi ne nga ata që shohin se çfarë ka pas kodrës, ne jemi nga ata që e shohin kodrën, e dinë pozitën e saj dhe asgjë tjetër...

Shqipëroi: Fehmi Maliqi



Hutbeja Mutekin *(Hammam)*

KËNDI I
NEHXHUL
BELAGAS

IMAM ALIU

Është transmetuar se një shok i Prijësit të Besimtarëve (a.s) me emrin Hammam, i cili kishte qenë i devotshëm ndaj Zotit, e kishte pyetur atë:

“O prijësi i besimtarëve, m’i përshkruaj njerëzit të cilët vërtet janë të devotshëm ndaj Zotit, ashtu që të kam përshtypjen se jam duke i shikuar ata”. Prijësi i Besimtarëve (a.s.) hezitoi për të dhënë përgjigje, por pastaj tha: “O Hammam, bëhu i vetëdijshëm ndaj Zotit dhe kryeji vepra të mira, nga se vërtet Ai është me ata të cilët janë të vetëdijshëm për Te dhe krahas kësaj janë edhe mirëbërës” (Kur’an, 16:128).

Hammami nuk ishte i kënaqur me këtë përgjigje, andaj e nxiti që të vazhdonte të fliste. Pas kësaj, Prijësi i Besimtarëve (a.s.) e madhëroi dhe e lëvdoi Allahun, dërgoi salavate mbi Pejgamberin e Nderuar (Selami i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij) dhe vazhdoi:

Dhe, dije se Allahu i Madhëruar dhe Lavdiplotë i krijoi krijesat atëherë kur i krijoi, tërësisht i pavarur nga nënshtrimi i tyre dhe i sigurt nga mosbindja e tyre, pasi që Atë nuk e dëmton mosbindja e atij që nuk i bindet, as nuk ka dobi nga bindja e atij që i bindet. Në mesin e tyre Ai ka shpërndarë begatitë për jetën e tyre dhe ua ka caktuar pozitat e tyre në këtë botë.

Kështu, ata të cilët janë të vetëdijshëm për Allahun në këtë botë janë bartës të denjë të vlerave;

– Të folurit e tyre është i drejtë;

– Veshja e tyre modeste, ndërsa ecja e tyre e qetë;

– Ata i ulin shikimet para asaj që Allahu ua ka ndaluar;

– Veshët e tyre i përmbajnë nga ajo dituri e cila është e dobishme për ta;

– Në sprova qëndrojnë njëjtë ashtu si kanë qenë në rahatitë jetësore.

– Po të mos ishte afati që u është caktuar, shpirtat nuk do të qëndronin në trupat e tyre as për një çast të vetëm, për shkak të dëshirës së tyre të zjarrtë për shpërblimin dhe frikës së tyre nga ndëshkimi;

– në zemrat e tyre Krijuesi është i madh, ashtu që çdo gjë tjetër përveç Tij është i parëndësishëm në sytë e tyre;

– Xheneti për ta është sikur janë duke e shikuar atë dhe ata kënaqen me begatitë e tyre. Për ata, edhe Xhehenemi është sikur janë duke e shikuar atë dhe duke i përjetuar vuajtjet në të;

– zemrat e tyre janë të pikëlluara;

– ata nuk bëjnë vepra të këqija;

– trupat e tyre janë të dobëta;

– kërkesat e tyre janë të vogla;

– ndërsa shpirtat e tyre janë të pastra;

– janë të durueshëm në kohën e cila është e shkurtër;

– kurse në fund fitojnë kënaqësinë e cila zgjatë shumë;

- kjo është një tregti e leverdishme të cilën e ka bërë të mundshme Zoti i tyre;
- kjo botë është drejtuar drejt tyre, por ata nuk janë drejtuar drejt saj;
- Ajo i kishte bërë peng, por ata i kanë blerë shpirtrat e tyre nga ajo;
- Gjatë natës ata qëndrojnë në këmbë duke lexuar pjesë nga Kur'ani dhe duke e recituar me maturi dhe në mënyrë harmonike;
- me këtë i mallëngjejnë shpirtrat e tyre dhe kërkojnë ilaç për ligështinë e tyre.
- Kur hasin në ndonjë ajet i cili nxitë dëshirën e madhe (për Xhennet), jepen mbas tij pasion dhe shpirtrat e tyre orientohen drejt tij me ngazëllim, kështu që e ndiejnë se Xheneti ndodhet para syve të tyre;
- ndërrsa, kur hasin në ndonjë ajet i cili i frikëson, i tendosin veshët dhe zemrat e tyre drejt tij dhe u bëhet se oshtima e Xhehenemit dhe britmat e tij arrijnë gjër te veshët e tyre;
- kërrusin shpinat e tyre, shkojnë në sexhde me ballin e tyre, me shuplakat e tyre, me gjunjët e tyre dhe me gishtat e këmbëve të tyre dhe vazhdimisht i luten Zotit të Madhëruar për shpëtimin e qafave të tyre;
- gjatë ditës janë bujar, të ditur, të devotshëm dhe të vetëdijsëm ndaj Allahut;
- frika ata i bën të hollë si shigjeta; ai që i shikon mendon se janë të sëmurë, mirëpo ata nuk janë të sëmurë, dhe thotë se janë bërë të çmendur, e në realitet, ata i ka përfshirë ajo që është madhështore;
- Ata nuk janë të kënaqur me numrin e vogël të veprave të mira të tyre, as nuk e konsiderojnë të madhe shumësinë e veprave të tyre të mira;
- gjithnjë e qortojnë veten dhe kanë frikë për veprat e veta;
- kur e lavdërojnë ndonjërin prej tyre, ai frikohet nga ajo që thuhet për te dhe thotë:

“E njoh veten time më mirë se të tjerët, kurse Zoti im njeh më mirë se unë.

Zoti im, mos vepro me mua në bazë të asaj çka flasin ata dhe më bën më të mirë se që mendojnë për mua dhe, më fal për atë që ata nuk kanë dijeni.”

- Veçoria e çdonjërit prej tyre në këtë qëndron në atë se ti i sheh te ai forcën e besimit, vendosmërinë me shpirtëmirësi, besimin me bindje, pasionin për dituri, diturinë në durim, maturinë në begati, përulësinë në devocion, mirësjelljen në varfëri, durimin në vuajtje, kërkimin e asaj që është e lejuar, zellin në udhëzim dhe përmbajtjen nga lakmia;
- Ai ndërmerr vepra të mira dhe shqetësohet;
- Mbrëmjeve është i pushtuar nga falënderime, mëngjeseve nga të përmendurit.
- Bie në gjumë plot vigjilencë dhe zgjohet në mëngjes plot hare.
- Është vigjilent që natën të mos e kalojë në harresë, ndërsa është i gëzuar për mirësinë dhe mëshirën që e ka fituar.
- Nëse pasioni i tij refuzon ta pranojë atë që nuk e do, ai nuk e pranon kërkesën e tij për të plotësuar atë që do ai.
- Kënaqësia e tij qëndron në atë që nuk është e përkohshme, ndërsa përmbajtja e tij është nga ajo që nuk zgjat përgjithmonë.
- Ai mirësjelljen e përshkon me dituri, ndërsa fjalën me vepër
- Ti e shikon se shpresa e tij është afër, pengesa e tij është e rrallë, zemrën e ka të përvojaj-

tur, shpirtin e ka të kënaqur, ushqimin e ka të thjeshtë, besimin e sigurt, pasionin të ngulfatur dhe zemërimin të mposhtur.

- Nga ai pritet vetëm mirësi dhe nuk duhet të ketë frikë nga e keqja e tij. Madje edhe po të gjendet në mesin e harrestarëve, do të llogaritet ndër ata që përkujtojnë. Nëse gjendet në mesin e atyre që përkujtojnë, nuk do të llogaritet prej atyre që janë harrestarë.

- E falë atë që ka qenë i padrejtë ndaj tij. I jep atij i cili nuk i ka dhënë. E viziton atë që nuk e ka vizituar.

- Fjala e shëmtuar qëndron larg prej tij, fjala e tij është e ëmbël, ligësia e tij nuk ekziston, virtutshmëria e tij është evidente, e mira e tij arin, ligësia e tij largohet.

- Është dinjitoz në fatkeqësi, i durueshëm në vuajtje, mirënjohës për begatitë e jetës. Nuk bën padrejtësi ndaj atyre që nuk i do dhe nuk bën mëkat për shkak të asaj që e do. E pranon të vërtetën para se t'i paraqitet argumenti. Nuk e dëmton atë që i është dhënë në ruajtje dhe nuk harron atë me çka paralajmërohet.

Të tjerët nuk i quan me emra përbuzës. Nuk i shkakton dëm fqinjët. Nuk e gëzon fatkeqësia e tjetrit. Nuk merr pjesë në padrejtësi dhe nuk e braktisë të drejtën.

- Nëse është i heshtur, heshtja atë nuk e pikëllon.

- Nëse qeshet, nuk e ngrit zërin.

- Nëse i bëhet padrejtësi, përmbahet gjersa Allahu nuk hakmerret për te.

- Njerëzit janë të qetë nga ai.

- Ai e hedh veten në vështirësitë e jetës së ardhshme dhe bën ashtu që njerëzit të ndjehen të sigurt nga ai.

- Largimi i tij nga ajo që largohet paraqet ngurrim dhe pastërti, gjersa të afëruarit e tij asaj që i afrohet paraqet shpirtmirësi dhe mëshirë.

- Largimi i tij nuk bëhet nga mendjemadhësia dhe krenaria, as të afëruarit e tij nuk bëhet me qëllim të mashtrimit dhe gënjeshtërs.



KURIOZITETE TË RRËFYERA PARA 1400 VITEVE

nga Profeti Muhammed




KRIJIMI I KARKALECIT

Prej një fjalimi (hytbeje) të Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të dhe Familjen e tij), në të cilën përshkruan krijimin e karkalecit fillon kështu:

Hythja – Fjalimi “Kam dëshirë të flas për karkalecin.”

Kur Allahu i krijoi atij dy sy të kuq, në bebet e zeza të syve të tij Ai bëri të rrezatojnë dy hëna. Ai i bëri atij dëgjim të fshehtë, hapi për të një gojë të shtrirë, i bëri karkalecit shqisa të fuqishme dhe dy dhembë me të cilët ai shqyen, si dhe dy drapërinj me të cilët ai kap. Fermerët tmerrohen prej karkalecit për të mbjellat e tyre dhe nuk kanë mundësi ta largojnë atë edhe sikur të mblidhen të gjithë së bashku pasi ai së bashku me “shokët”, për të kryer dëshirat e tyre, i kthejnë të mbjellat në tokë të lëruar. Krijimi i karkalecit si tërësi nuk është një gjë e vogël e parëndësi, që tregohet me gisht për t’u tallur.”

KARKALECI: Karkalecat janë grup i madh i insekteve (mbi 10.000 lloje) të përhapura në vendet e ndryshme të botës. Në kokë kanë dy antena të gjata, ndërsa aparati i gojës është i përshtatur për grimcim. Kanë dy palë krahë. Këmbët e prapme i kanë shumë të zhvilluara dhe iu shërbejnë edhe për kërcime të gjata. Karkalecat ushqehen me bimë dhe në vendet ku kalojnë tufat e tyre, dëmtojnë shumë kulturat bujqësore




KRIJIMI I MILINGONËS

Prej hytbes së mësipërme, përshkruan gjithashtu milingonën:

“Shikojeni milingonën me hijeshinë e pamjes, me trupin e saj të vogël. Ajo është aq e përkryer, sa nuk arrin ta perceptosh me një shikim të vetëm, me një mendim të thjeshtë. Shiko si ecën mbi tokë e si hidhet mbi ushqimin e saj. Ajo e mbart farëzën për në strehën e vet dhe e përgatit në vendbanimin e saj. Milingona e mbledh ushqimin e vet në të nxehtë e në të ftohtë, pasi ka shëtitur shumë në kërkim të tij. Milingonën Ushqyesi (Zoti) nuk ia mbyll ushqimin, Llogarimarrësi nuk e kufizon milingonën nga mbledhja e ushqimit, as në tokën e thatë dhe as në gurin e fortë. Sikur të mendohesh rreth gypave të ushqimit të saj, ose për ato që ajo ka nga sipër e nga poshtë, ose për brinjët që ajo ka në bark, si dhe për sytë e veshët që ajo ka në kokë, patjetër do të gjykoje i mahnitur për krijimin e milingonës dhe do të lodheshe shumë nëse do të mundohesh për ta përshkruar atë. Sikur të udhëtosh nëpër rrugët e mendimit tënd, që të arrish të kuptosh qëllimin e Tij, faktet do të tregojnë për ty se Krijuesi i milingonës është edhe Krijuesi i hurmës. Faktet do të tregojnë imtësitë e çdo sendi dhe të fshehtë të ndryshueshmërisë së çdo gjallese.”

- Hyrja e folesë së milingonës drejtohet përherë nga Veriu.
- Milingonat e ndjejnë tërmetin që më parë dhe dalin menjëherë nga foleja.



KRIJIMI I LAKURIQIT TË NATËS

Prej një fjalimi (hytbeje) tjetër, ku ai përmend krijimin e mahnitshëm të lakuriqit të natës:

“Prej hollësive të shpikjes së Tij dhe çudive të urtësisë së Tij, janë ato që Ai na tregon prej të fshehtave të urtësisë që ka në krijimin e lakuriqit të natës të cilin në ndryshim nga të gjitha gjallesat, e mbledh drita dhe e shpërndan errësira. Si jetojnë sytë e tij pa marrë dritë prej diellit të ndritshëm me të cilën të drejtohet në rrugën që ndjek dhe me anë të kësaj drite të arrijë te të njohuritë e tij?

Duket sikur lakuriqi i natës ka hequr dorë nga drita e diellit dhe të gjitha shkallët e ndriçimit nuk e lënë atë të lëvizë. Lakuriqi i natës gjatë ditës qëndron i varur nëpër vende të errëta, natën e ka llambë, të cilën ai e ngre për të kapur ushqimin. Atij nuk ia kthen sytë as errësira më e fortë e natës, as nuk ia ndalon shikimin e tij errësimi i qiellit prej reve e prej përflakjes së perëndimit të diellit; kur dielli e heq mbulesën e vet dhe dita bëhet e qartë, atëherë kur kafshët e natës hyjnë nëpër zgavrat e veta, lakuriqi i natës lëshon qerpikët poshtë, duke u mjaftuar me ushqimin që ka fituar në errësinë e natës. I Plotpushtetshëm është vetëm Ai që për lakuriqin e natës, natën e ka bërë ditë në të cilën ai siguron jetesën, kurse ditën për lakuriqin e natës Ai e ka bërë pushim e qetësi. Ai ka bërë për lakuriqin e natës dy krahë prej mishit të tij, me të cilat ai lëshohet në fluturim sipas nevojës. Dy krahët e tij janë të buta si pjesa e poshtme e veshit të njeriut, pa pupla e pa pendë, por në ato ti shikon qartë enët e gjakut.

Dy krahët e tij janë të butë dhe nuk rëndojnë kur ai i mbyll për të qëndruar i varur. I vogli i lakuriqit të natës qëndron me nënën e vet dhe ajo është strehë për të voglin e saj, i cili ulet kur ajo qëndron dhe ngrihet së bashku me të, kur nëna e tij fluturon i vogli nuk ndahet nga nëna derisa të fitojë fortësinë e trupit e të jetë në gjendje të ngrihet e të hapë vetë krahët e tij, të njohë rrugët që e çojnë drejt ushqimit dhe aty ku është e mira e tij. I plotpushtetshëm është vetëm Filluesi i çdo krijese, pa pasur një model para krijimit të tij.”

Lakuriqet fluturojnë vazhdimisht në errësinë, duke lëshuar disa tinguj të veçante. Kur tingulli bie mbi ndonjë objekt, p.sh., degë, shkakton një jehonë dhe lakuriqi menjëherë e kupton se ka përpara një objekt dhe e anashkalon atë. Mund të themi se lakuriqi ka një radar që u largohet pengesave të cilët ne nuk e kemi një radar të tillë.

Edhe pse sytë e lakuriqeve të natës janë të vegjël dhe pak të zhvilluar, duke çuar në një mprehtësi të varfër vizuale, asnjëri prej tyre nuk është i verbër. Vizioni është përdorur për të drejtuar lakuriqet e natës veçanërisht për distanca të gjata. Gjithashtu është zbuluar se disa lloje janë në gjendje të zbulojnë dritën ultravjollcë. Ata gjithashtu kanë një cilësi të lartë në ndjesinë e nuhatjes dhe dëgjimit. Lakuriqet gjuajnë gjatë natës për të shmangur konkurrencën me zogjtë, dhe udhëtojnë në distanca më të mëdha se 800 km, në kërkimin e tyre për ushqim.

Përgatiti e përktheu Zehra Huduti



Fjalë të urta nga Imam Aliu

paqja qoftë mbi të.

- Nëse i verbëri nuk e sheh diellin
nuk do të thotë që dielli nuk egziston.
- Thënia e të vërtetës është shpëtim i njeriut.
 - Trupi shëndoshet me agjërime.
- Dorështrenguarit i ngushtohet zemra.
 - Bindja ndaj Zotit është fitore.
 - Varfëria është vuajtje e madhe.
 - Agimi ka aguar për ate që ka sy.
- Kokëfortësia e shkatërron mendjen.
 - Kur rritet aftësia, zvogëlohet frika.
- Feja gremiset me vdekjen e dijetarëve.
 - Roba e shpëtimit nuk vjetërsohet.
- Dyfishoje bamirësinë tënde me ndjesë.
- Thënia e të vërtetës është shpëtim i njeriut.
 - Durimi sjell fitim.
- Rruajtja e gjuhës është shpëtim i njeriut.
 - Heshtja sjell qetësinë e trupit.
 - Zemra kthjellohet me besimin.
- Mjaftimi me pak e bën jetën e kënaqshme.
- Vizito të afërmit e tu që të shtohet nderi.
 - Falja e natës është ndriçim i ditës.
- Heshtja është mbulesa e pa diturisë.



KËSHILLAT E PROFE

për muajin

"Sikur ta dinte njeriu se çfarë mirësish ka në muajin e Ramazanit, do të dëshironte të ishte i gjithë viti Ramazan"

"Nuk ka besimtar, që agjëron një ditë të muajit të Ramazanit - me nijet arritjen e shpërblimeve të tij - e që Allahu i Lartësuar të mos i japë shtatë shkëlqyeshmëri: 1. Ushqimi i ndaluar që i ka hyrë në trup i shkrihet. 2. I afrohet më pranë mëshirës së Allahut. 3. Allahu ia lan-gjynahet. 4. Allahu ia pakëson vuajtjet e ydekjes. 5. Allahu e mbron nga uria dhe etja në Ditën e Gjykimit. 6. Falet nga dënimi i Skëterrës. 7. Allahu i siguron ushqimin e mirë dhe të shijshëm të Xhenetit."

"Ai është muaji i durimit, dhe s'ka dyshim se shpërblimi i durimit është Parajsa."

"Fillimi i muajit Ramazan është mëshirë, mesi i tij është falje dhe fundi i tij, shpëtim nga zjarri i Xhehenemit"

"Pa dyshim, muaji i Ramazanit është quajtur ashtu sepse djeg mëkatet."

"Muaji i Ramazanit është muaji në të cilin Allahu, Fuqiplotë e i Lavdishëm, jua ka bërë obligim agjërimin. Ndaj, ai që agjëron në këtë muaj në gjendje besimi dhe me synim shlyerjen, do të pastrohet nga mëkatet ashtu siç ishte në ditën kur e lindi e ëma."

"Çdo natë në muajin e Ramazanit Allahu i Madhërishëm e i Lartësuar thërret tri herë: A ka ndonjë që kërkon prej Meje, që t'ia plotësoj kërkesën? A ka ndonjë që kthehet drejt Meje me pendesë, që Unë të kthehem drejt tij (me mëshirë)? A ka ndonjë që Më kërkon falje, që Unë ta fal?"

"Dimri është pranvera e besimtarit, sepse në këtë stinë nata është e gjatë, ndaj besimtari e kalon me namaz, kurse dita është e shkurtër, të cilën besimtari e agjëron"



TIT MUHAMED S.A.A

n Ramazan



"Të bekuar janë ata që agjërojnë për Allahun, sepse në ditën e Gjykimit ata do të jenë të ngopur."

"Agjërimi është për mua, prandaj unë shpërblej për atë."

"Çdo kush që agjëron, ta çelë iftarin me hurma dhe nëse nuk gjen hurma, ta çelë me një gotë ujë të pastër"

"Zoti i Madhërishëm dhe engjëjt dërgojnë përshëndetje dhe selam, për ata që bëjnë syfyr, prandaj secili prej jush duhet të hajë syfyr, qoftë edhe nëse është sa një pikë uji."

"Atij që i shtron iftar një besimtari në muajin e Ramazanit do t'i jepet shpërblimi i atij që ka liruar një rob (në rrugën e Allahut) dhe do t'i falen mëkatet e mëparshme. E nëse nuk ka patur më shumë se qumësht të përzier me ujë për të ofruar, ose ujë të ëmbëlsuar dhe një hurmë, Allahu prapë do ia japë shpërblimin."

"Ramazani është Muaji i veprave të mira"

"Ky muaj i juaji nuk është si të tjerët. S'ka dyshim se kur afrohet, ju sjell bekime e mëshirë dhe kur largohet, ju merr mëkatet. Ky është një muaj në të cilin veprat e mira shumëfishohen dhe mirësia pranohet."

"Vërtet, ju erdhi muaji i Ramazanit, muaji i bekuar, në të cilin Allahu ju ka obliguar agjërimet. Në të, dyert e Xhennetit janë të hapura e shejtanët janë të lidhur; dhe në të është Nata e Kadrit, që është më e virtytshme se një mijë muaj."

"Ai është muaji i durimit, dhe s'ka dyshim se shpërblimi i durimit është Parajsa."

"O Allah! Mos e cakto këtë muaj të Ramazanit të jetë i fundit për agjërimet e mia. Por nëse e cakton, atëherë bekomë dhe mos më privo (nga mëshira Jote)

Veprat dhe Lutjet e veçanta gjatë MUAJIT RAMAZAN

NATA E PARË E HYRJES NË RAMAZAN:

- a) Përpjekje për shikimin e hënës së Ramazanit. Disa dijetarë (teologë) e kanë bërë të obligueshme këtë çështje.
- b) Gusli (larja).
- c) Katër rekate namaz ku lexohet: Surja El Fatiha dhe surja El Ihlas 20 herë (d.m.th. në një rekat surja El Ihlas lexohet nga 5 herë.)
- d) Të lexohet sa më shumë Kur'ani
- e) Leximi i lutjeve të llojllojshme që i keni në këtë libër.

DITA E PARË

Në këtë ditë kryen këto veprime:

- 1-Gusli (larja) deri para syfyrit të parë
- 2-Dhënia e sadakasë (bimirësisë për varfanjakë e jetimë) gjatë kësaj dite.

LUTJA (PAS SYFYRIT TË PARË)

“O Zot: Bëje agjërimin tim në këtë muaj si ai i agjëruessve të vërtetë; dhe namazin tim në këtë muaj si ai i falësve të singertë; dhe më zgjo prej gjumit të pavëmendshëm; dhe fali mëkatet e mia në këtë muaj, O Zot i botëve, O Falës i mëkateve dhe i kriminelëve. O Zot!”

NATA E PARË

Falen katër rekate namaz, në çdo rekat lexohet një herë surja El Fatiha dhe 15 herë surja El Ihlas.

DITA E DYTË

LUTJA

“O Zot: Më afro në këtë muaj tek begatitë e Tua dhe më largo në këtë muaj prej zemërimeve dhe hakmarrjeve të Tua. Më mbarëso në këtë muaj që të lexoj ajetet (verset) e Kur'anit Tënd. Me mëshirën Tëndë o Mëshirues, o Mëshirëbërës! O Zot i Madh!”

NATA E DYTË

Falen katër rekate namaz. Në çdo rekat lexohet surja El Fatiha dhe 20 herë surja El Kadër (në çdo rekat lexohet nga 5 herë surja el Kadër).

DITA E TRETË

LUTJA

“O Zot: Më dhuro në këtë muaj mendim dhe paralajmërim; dhe më largo prej marrëzive dhe moskuptimit; dhe më cakto pjesë prej të mirave të Tua, të cilat i zbrite në këtë muaj, me Bujarinë Tëndë, O Dhënës, O Bujar, O Zot i Madh”.

NATA E TRETË

Falen dhjetë rekate namaz dhe lexohet surja El Fatiha dhe surja El Ihlas 50 herë, (d.m.th. në çdo rekat lexohet nga pesë herë surja El Ihlas).

DITA E KATËRT

LUTJA

“O Zot: Më jep fuqi në këtë muaj që t'i kryej obligimet e Tua. Më provo në këtë muaj ëmbëlsirën e dhikrit Tënd dhe më veço mua në këtë muaj që të të falënderoj Ty për dhëniet e Tua të shumta. Më mbro me mbrojtjen Tëndë dhe me mbulimin Tënd, o Shikues, o Zot i Madh!”

NATA E KATËRT

Falen tetë rekate namaz. Në çdo rekat lexohet surja El Fatiha dhe surja El Kadër 20 herë.



(d.m.th. në 4 rekatë surja El Kadër lexohet nga 3 herë, kurse në 4 rekatë lexohet nga 2 herë. Pra, gjithsej, surja El Kadër lexohet 20 herë).

DITA E PESTË

LUTJA

“O Zot: Më bëj në këtë muaj prej të penduarave; dhe më bëj prej adhuresve të Tu të pëlqyeshëm; dhe më bëj në këtë muaj prej evliave të Tu të afrueshëm tek Ti, me Mëshirën Tënde O Mëshirues, O Mëshirëbërës, O Zot i Madh!”

NATA E PESTË

Falen dy rekatë namaz dhe lexohet surja El Fatiha dhe surja El Ihlas 50 herë, (d.m.th. në çdo rekat surja Ihlas lexohet nga 25 herë).

Mbas namazit dërgohen 100 herë salavate mbi Pejgamberin dhe mbi familjen e Muhamedit (s.a.a)

ALLAHUM-ME SAL-LI A'LA

MUHAM-MED VE ALIHI

MUHAM-MED

DITA E GJASHTË

LUTJA

“O Zot: Mos më poshtëro në këtë muaj dhe mos më dëno me kamxhikët e hakmarrjes Tënde. Më largo prej zemërimeve të Tua, për hir të dhënies Tënde të shijshme, o Plotësues i dëshirave të dëshirueseve, o Zot i Madh!”

NATA E GJASHTË

Falen katër rekatë dhe lexohet surja El Fatiha dhe surja El Mulk. Si kjo ditë, pra me 6-të Ramazan të vitit 201 të Hixhrit, u bë betimi i Imam Ridhait (Allahu qoftë i kënaqur me të). Në këtë natë është mustehab (e pëlqyeshme) të falen dy rekatë namaz falënderimi, ku lexohet surja El Hamd dhe surja El Ihlas 25 herë. (Në njërin rekat, surja El Ihlas (apo siç e njeh populli Kulhuvalahi) lexohet 10 herë, kurse në tjetrin lexohet 15 herë.)

DITA E SHTATË

LUTJA

“O Zot: Më ndihmo në agjërimin e Ramazanit, më ndihmo që të fal namazet në Ramazan, më largo prej gabimeve dhe mëkatëve dhe më mbarëso në këtë muaj me dhikrin Tënd gjatë gjithë kohës së Ramazanit, o Mbarësues, o Orientues i të humburve, O Zot i Madh!”

NATA E SHTATË

Falen katër rekatë namaz dhe lexohet surja El Hamd (Fatihaja) dhe surja El Kadër 13 herë. (ndajini sipas dëshirës)

DITA E TETË

LUTJA

“O Zot. Mbille tek unë mëshirën ndaj jetimëve në këtë muaj dhe shumëfishoje furnizimin e të uriturve, përhapjen e paqes dhe shoqërimin e bamirësive, për hir të pafundësisë Tënde, o Strehues i të strehuarve, o Zot i Madh!”

NATA E TETË

Falen dy rekatë namaz ku lexohet surja El Fatiha dhe surja El Ihlas 10 herë. (Në çdo rekat lexohet nga 5 herë).

Mbas namazit thuhet njëmijë (1000) Subhanallah (I Lartësuar je o Allah).

DITA E NËNTË

LUTJA

“O Zot: Më cakto mua një pjesë të Mëshirës Tënde në këtë muaj. Më oriento me argumentet e Tua të ndershme dhe më tërhiq mua në dashurinë Tënde. O i Dashur, për hak të Dashurive të Tua. O Shpresa e mallëngjyesve të Tu, O Zot i Madh!”

NATA E NËNTË

Në këtë natë falen gjashtë rekatë namaz, në mes të namazit të akshamit (magrib) dhe namazit të jacisë (Ishasë). Në çdo rekat lexohet një herë surja El Fatiha dhe gjashtë herë Ajetul Kursija. Mbas namazit thuhet 50 herë salavatet mbi Muhamedin (s.a.a.) dhe familjen e Tij të pastër (a.s.).

DITA E DHJETË

LUTJA

“O Zot: Më bëj mua në këtë muaj prej mbështetësve të Tu dhe më bëj mua prej afruesve të Tu, për hak të Mirësive të Tua, o Plotësues i dëshirave të kërkueseve, o Zot i Madh!”

NATA E DHJETË

Në këtë natë falen 20 rekate namaz, ku lexohet surja El Fatiha dhe surja El Ihlas 30-të herë. (ndaji sipas dëshirës)

DITA E NJËMBËDHJETË

LUTJA

“O Zot: M’i bëj të pëlqyeshme të mirat në këtë muaj dhe m’i bëj të papëlqyeshme kundërshtimet dhe të këqijat e mia në këtë muaj. Më mbroj nga zemërimi dhe zjarri Yt, me mbrojtjen Tënde, o Strehues, o Ndihmues, o Zot i Madh!”

NATA E NJËMBËDHJETË

Në këtë natë falen dy rekate namaz, ku lexohet një herë surja El Fatiha dhe njëzet 20 herë surja El Keuther. (ndaji sipas dëshirës)

DITA E DYMBËDHJETË

LUTJA

“O Zot: Më zbukuro në këtë muaj duke m’i mbuluar të këqijat dhe duke më nderuar. Më mbulo në këtë muaj me rrobat e bindjes dhe të barazisë dhe më ruaj nga padrejtësia, dhe më mbro prej atij që i frikësohem, me mbrojtjen Tënde, O Mbrojtës i të frikësuarve, o Zot i Madh!”

NATA E DYMBËDHJETË

Në këtë natë falen tetë (8) rekate namaz, ku lexohet surja El Fatiha dhe 30 herë surja El Kadër.

DITA E TREMBËDHJETË

LUTJA

“O Zot! Më pastro në këtë muaj prej ndyrësive dhe më bëj të durueshëm ndaj detyrave dhe obligimeve të të tjerëve. Më mbarëso në këtë muaj duke u mbështetur tek Ti dhe duke u sho-

qëruar me të mirët me mbrojtjen Tënde, o Drita e syve të të mjerëve, o Zot i madh!”

NATA E TREMBËDHJETË

Në këtë natë falen katër rekate namaz, ku lexohet surja El Fatiha dhe njëzet herë surja El Ihlas.

DITA E KATËRMBËDHJETË

LUTJA

“O Zot: Mos më dëno për shkak të mëkateve të mia në këtë muaj dhe m’i pakëso gabimet dhe fajet e mia në këtë muaj. Mos më ballafaqo në këtë muaj me fatkeqësi dhe bela, për hir të dashurisë Tënde, o i dashuri i myslimanëve, o Zot i Madh”.

NATA E KATËRMBËDHJETË

Në këtë natë falen gjashtë rekate namaz, ku në çdo rekat lexohet surja El Fatiha dhe 30 herë surja Zilzaleh.

DITA E PESËMBËDHJETË

LUTJA

O Zot: Më mbarëso në këtë muaj duke t’u përu-lur për shkak të frikësimit nga Ti dhe më hap gjoksin në këtë muaj duke më udhëzuar dhe orientuar qartë, me sigurinë Tënde, o Sigurues i të dobëtëve, o Zot i Madh”.

NATA E PESËMBËDHJETË

Në këtë natë falen katër rekate, ku lexohen: surja El Fatiha dhe 100 herë surja El Ihlas.

Më 15-të Ramazan, të vitit të dytë të Hixhrit, ka lindur Imam Hasan El Muxheteba (Allahu qoftë i kënaqur me të). Në këtë ditë është mustehab (e preferuar) të jepet sadaka dhe të bëhen vepra të mira.

DITA E GJASHTËMBËDHJETË

LUTJA

“O Zot: Më mbarëso në këtë muaj duke më bashkuar me të mirët e Tu dhe më largo në këtë muaj nga të këqijat. Më bëj të banoj në parajsë në këtë muaj, për hak të adhurimit Tënd, o Adhurues i të gjithë njerëzisë, o Zot i Madh!”

NATA E GJASHTËMBËDHJETË

Në këtë natë falen 12-të rekate namaz, ku lexohet surja El Fatiha dhe 12 herë surja El Tekathur.

DITA E SHTATËMBËDHJETË

LUTJA

“O Zot: Më oriento në këtë muaj në vepra të mira. M’i plotëso në këtë muaj të gjitha nevojat dhe shpresat e mia. O Zot: Ti nuk ke nevojë për sqarime dhe pyetje, o i Dijshmi i gjërave në gjokset e njerëzve, paqja Jote qoftë mbi Muhamedin dhe mbi familjen e Muhamedit (s.a.a.), të pastër dhe të kulluar”.

NATA E SHTATËMBËDHJETË

Në këtë natë falen dy rekate. Në rekatën e parë lexohet surja El Fatiha dhe një sure që ju dëshironi, kurse në rekatën e dytë lexohet surja El Fatiha dhe 100 herë surja El Ihlas.

Mbas namazit thuhet 100 herë ‘La Ilahe il-la Allah’. Kjo është natë e bekuar sepse në të ka ndodhur Lufta e Bedrit. Është mustahab të japësh sadaka dhe të bësh ibadet.

DITA E TETËMBËDHJETË

LUTJA

“O Zot: Më zgjo në të mirat e syfyrit të Ramazanit dhe ndriçoje zemrën time me ndriçimin e dritave të Ramazanit. Bëji organet e trupit tim ndjekës të dritave të Ramazanit, për hir të dritës Tënde, o Ndriçues i zemrave të kuptueshme. O Zot!”

NATA E TETËMBËDHJETË

Në këtë natë falen katër rekate namaz, ku lexohet surja El Fatiha dhe 25 herë surja El Keuther.

DITA E NËNTËMBËDHJETË

LUTJA

“O Zot: Zgjeroje fatin tim në këtë muaj në drejtim të mirësive të Ramazanit dhe lehtësoji rrugët e mia në kërkim të begative dhe mos ma bëj haram pranimin e të pëlqyeshmeve të Ramazanit. O Orientues në drejtësi, o Zot”.

NATA E NËNTËMBËDHJETË

Në këtë natë falen 50 rekate namaz . Në to lexohet nga një herë surja El Fatiha dhe surja El Zelzeletu. Kjo është nata e parë e Kadrit.

DITA E NJËZETË

LUTJE

“O Zot: M’i hap dyert e xhenetit në muajin ramazan dhe m’i mbyll dyert e xhehenemit. Më mbarëso të lexoj Kur’anin Tënd. O Zbritës i qetësisë në zemrat e besimtarëve. O Zot!”

NATA E 20-21-22-23-24: E RAMAZANIT

Në këto net falen 8 rekate namaz dhe në to lexohet surja El Fatiha dhe mbas saj lexohet çfarëdolloj sureje që dëshirohet.

DITA E NJËZETENJËTË

Kjo është dita e vdekjes së Imam Aliut (r.a.). Është e preferuar (mustehab) të bëhet vizitë (zijalet).

DUAJA E DITËS SË NJËZETENJËTË

“O Zot: M’i bëj argumente begatitë e Tua në muajin ramazan dhe mos më bëj të shkoj pas hapave të djallit. Bëje xhenetin vendbanimin Tim, O Plotësues i nevojave të kërkuesve! O Zot!”

DUAJA E DITËS SË NJËZETEDYTË

“O Zot: M’i hap dyert e dobive të ramazanit dhe m’i zbrit bereqetet e Tua në muajin ramazan. Më mbarëso që të punoj punë të pëlqyeshme tek Ti në muajin ramazan dhe më bëj të banoj në parajsën Tënde. O Përgjegjës i lutjeve të të paafteve. O Zot!”

DUAJA E DITËS SË NJËZETETRETË

“O Zot: Më pastro prej mëkateve në muajin ramazan dhe më pastro prej të këqijave. Provoje zemrën time me mbështetjen tek Ti, o Pakësues i mëkateve, o Zot!”

DAUJA E DITËS SË NJËZETEKATËRT

“O Zot: Unë mbështetem tek Ti në këtë muaj për ato gjëra që Ti i pëlqen dhe mbështetem tek Ti për ato gjëra të cilat të zemërojnë dhe të lus në këtë muaj që të më mbarësosh me përluljen

ndaj Teje dhe që të mos i kundërshtoj urdhrat e Tua, o Dhënës i pyetjeve, O Zot!”

DITA E NJËZETEPESTË

LUTJA

“O Zot: Më bëj në këtë muaj të dashur për evliatë e Tu dhe armik për armiqtë e Tu, zbatues të synetit të Pejgamberit Muhamed (s.a.a.), i cili është vula e pejgamberëve të Tu, o Mbrojtës i zemrave të pejgamberëve, o Zot”.

NATA E NJËZETEPESTË

Në këtë natë falen 8 rekate, ku lexohet surja El Fatiha dhe 10 herë surja El – Ihlas.

DITA E NJËZETEGJASHTË

LUTJA

“O Zot: M’i bëj ecjet e mia në Ramazan të falënderuara, m’i bëj mëkatet e mia të faluara, m’i bëj punët e mia të pranueshme dhe m’i mbulo të këqijat, o Dëgjues, o Zot!”

NATA E NJËZETEGJASHTË

Në këtë natë falen 8 rekate namaz, ku lexohet një herë surja El Fatiha dhe 100 herë surja El Ihlas.

DITA E NJËZETESHTATË

LUTJA

“O Zot: Më begato me të mirat e natës së Kadrit, shndërroji çështjet e jetës sime nga të vështira në të lehta, m’i prano lutjet e mia dhe zhduki mëkatet e mia, o Mëshirues i adhuruesve të Tu të singertë, o Zot”.

NATA E NJËZETESHTATË

Në këtë natë falen 4 rekate namaz, ku lexohet surja El Fatiha dhe surja El Mulk. Nëse nuk është e mundur të lexohet surja El Mulk atëherë preferohet që në vend të saj të lexohet 25 herë surja El Ihlas. Në këtë natë është mustehab (e preferuar) larja (gusli).

DITA E NJËZETETETË

LUTJA

“O Zot: Zmadhoji fatet e mia gjatë faljes së na-

fileve, më beko në këtë muaj më bujarinë Tënde duke iu përgjigjur lutjeve të mia dhe m’i afro në këtë muaj mjetet e mbërritjes tek Ti, o Zot!”

NATA E NJËZETETETË

Në këtë natë falen gjashtë rekate namaz. Në to lexohet një herë surja El Fatiha, 10 herë Ajetul Kursija, 10 herë surja El Ihlas, 10 herë surja El Keuther dhe mbas namazit thuhet 100 salavatë për Muhamedin dhe familjen e tij (s.a.a.).

DITA E NJËZETENËNTË

LUTJA

“O Zot: Më mbulo me mirësinë Tënde në këtë muaj, më dhuro në këtë muaj mbarësi dhe mbrojtje dhe pastroje zemërimin tim prej akuzimeve dëmtuese, o Mëshirëbërës ndaj adhuruesve të Tu besimtarë, o Zot!”

NATA E NJËZETENËNTË

Në këtë natë falen 2 rekate namaz, ku lexohet surja El Fatiha dhe 20 herë surja El Ihlas.

DITA E TRIDHJETË

LUTJA

“O Zot: Bëje agjërimin tim të falënderuar dhe të pranuar, ashtu siç dëshiron Ti dhe ashtu siç dëshiron Pejgamberi Yt. Bëj që degët e agjërit të jenë të lidhura me parimet e Tij, për hir të Muhamedit dhe familjes së tij (s.a.a.)

NATA E TRIDHJETË

Në këtë natë falen 12 rekate namaz, ku lexohet surja El Fatiha dhe 20 herë surja El Ihlas. Mbas namazit thuhet 100 salavatë për Muhamedin dhe familjen e tij (s.a.a.).

Veprime të përgjithshme

NË NATËN E KADRIT

**NETËT E 19-TA, 21-TA, 23-TA 25-TA, 27-TA
JANË NETËT E BEKUARA**

Veprimet në këto net janë:

- 1- Gusli (larja).
- 2- Namaze me 2 rekate, ku lexohet surja El Fatiha dhe mbas saj lexohet 7 herë surja El Ihlas.
- 3- Mbas namazit bëhet 70 herë istigfar (pendim), duke thënë:
'Estagfirulla ve Etubu Ilejh'.
- 4- Ndenjja zgjuar.
- 5- Namaze me 100 rekate, ku lexohet surja El Fatiha dhe surja El Ihlas për çdo rekat.
- 6- Merret Kur'ani para duarve duke thënë: "O Zot! Unë të drejtohem Ty për librin Tënd të zbritur dhe për atë që gjendet në brendësi të Kur'anit. Dhe në brendësi të Kur'anit gjendet emri Yt i Madhërueshëm dhe cilësitë e Tua të Larta. Të drejtohem Ty për çdo gjë frikësuese dhe shpresuese që ndodhet në Kur'an. Më çliro prej zjarrit Tënd, o Zot!" (kërkoji nevojat e tua).

**VEPRAT NË NATËN E FUNDIT
TË MUAJIT RAMAZAN**

Këto veprime janë të vlefshme dhe mustehab (të preferuara). Ndër to përmendim:

- 1- Gusli (larja).
- 2- Leximi i sureve: El Enamë, El Kehf, Jasinë dhe thënia: 'Estagfirullahe ve Etubu Ilejh' - 100 herë.
- 3- Leximi i kësaj lutje: "O Zot: Muaj ramazan në të cilin ke zbritur Kur'anin po mbaron dhe unë mbështetem në pamjen Tënde të bekuar. O Zot, unë të drejtohem Ty që, - nëse zbardh mëngjesi i këtyre netëve të bekuara, ose përfundon muaji ramazan dhe tek Ti janë të shënuara gjynahet dhe mëkatet e mia me të cilat do të më torturosh në Ditën e Gjykimit, - të m'i falësh këto mëkate, Ja Erhame Rrahimin, O Zot".
- 4- Thënia: "O Zot: Mos e bëj këtë ramazan të fundin e ramazaneve dhe të drejtohem Ty që, nëse zbardh mëngjesi i kësaj nate, të më falësh mua, o Zot!"
- 5- Namaze me 10 rekate, ku lexohet surja El Fatiha dhe 10 herë surja El Ihlas.

VEPRIMET NË DITËN E BAJRAMIT

- 1- Tekbirë mbas namazit të sabahut dhe mbas namazit të Bajramit.
- 2- Dhënia e Zekatit të Fitrit para namazit të Bajramit.
- 3- Gusli (larja). Koha e tij është nga agimi e deri para faljes së namazit të Bajramit.
- 4- Lutja e guslit (larjes): "O Zot, bëje këtë larje pastruese të mëkateve të mia dhe pastroje besimin tim. O Zot, largoji prej meje ndyrësitë".
- 5- Veshja e rrobave të bukura dhe përdorimi i erërave të këndshme.
- 6- Të ngrënit në fillim të ditës dhe para namazit të Bajramit.
- 7- Shkuarja në xhami për të falur namazin e Bajramit.





Kontributi i Ahmad Ibn Rustah NË ZHVILLIMIN E GJEOGRAFISË

M.SC. ARTAN S. MEHMETI



Ahmad Ibn Rustah
(?-903)

I lindur në rajonin Rosta afër qytetit Isfahan të Persisë, e në këtë kohë ky rajon i takon Iranit. Ibn Rustah njihet eksplorues dhe gjeograf.

Është i njohu si autor i përmbledhjes gjeografike me titull “Ketāb al-a’lāq al-nafisa”. Në këtë libër ai përmend që ka qenë në Medina, ku sipas të gjitha gjasave ky do të kishte qenë i vetmi udhëtim i rëndësishëm jashtë Persisë së vjetër gjatë jetës së tij. Libri i tij është i shkruar në dy pjesë (dorëshkrime). Pjesa e shtatë e këtij libri është më e zgjeruar dhe përmban në enciklopedi në vete, ku autori në këtë pjesë shkruan për shumë fusha shkencore. Volumi që ka mbi jetuar kohës bën fjalë për gjeografinë dhe temat tjera të përbashkëta. Libri fillon me gjeografinë qiellore dhe astronomike, duke i cituar autorët sikur që janë gjeografi Ebu Tayyeb Saraksi dhe

astronomi i famshëm Ebu Mashar Balki, si dhe botëkuptime të zgjeruara të marra nga Grekët. Pastaj, Ibn Rustah kalon në një përshkrim të dy qyteteve (Mekën dhe Medinen), ku i përshkruan në detaje topografinë dhe ndërtesat me shumë karakteristika të mrekullueshme e me stile hyjnore.

Duke u marrë me pjesën tjetër të botës, ai përshkruan detet dhe lumenjtë e tyre; shtatë lartësirat (duke e përcjellur sistemin Grek të klimata-s para asaj Persiane të keşvars.); regionet e Dār-al-Eslām (duke filluar me Īrānšahr dhe Sawād të Irakut.), e të cilat i ka trajtuara me kujdes të veçantë; Perandorin Bizantine dhe perandorët e tij me detaje të shumta; Roma, vend për të cilën nuk ka pasur shumë informa-



ta; dhe për vendet jo Islamike dhe racat e tyre, përfshirë Indinë, njerëzit e Turqisë të Azisë së brendshme, si dhe, hungarezet – magjarët (al-Majgariya), sllavët (al-Saqlabīya), Rusët (al-Rūsīya), Alanët, etj. Më tutje ai kthehet në një përshkrim të Persisë, veçanërisht Isfahanin dhe i përshkruar rrugët kryesore të perandorisë duke ju dhënë rëndësi më të madhe atyre të Persisë. Ai mbaron me disa informata të shkurtura mbi awā'el, “ndodhitë e para,” familjet e famshme, sektet dhe heretikët para dhe pas islamik, etj.

Metoda e Ibn Rostas është e bazuar dhe është zhvilluar në ashtuquajturën gjeografia e shkruar në rrugë, d.m.th. ai i përshkroi vendet në kohën që i vizitoi (me sa duket ai e mori itinerarin dhe vendet nga Ibn Kordādbēh, edhe pse atë vetëm një herë e përmend, por në përgjithësi kjo duket qartë, kështu që libri i tij shndërrohet në një enciklopedi koncize të dijes kosmologjike, gjeografike dhe historike).

Puna e Ibn Rostas mund të vendoset në të ashtuquajturën shkollë “Irake” të shkrimeve gjeografike sesa një shkollë “Balkī” e Abū Zayd Balkī, e cila shkollë e mori inspirimin nga konceptet gjeografike në Kuran. Qasja e tij në literaturën një adīb-i (literari), është e nxitur nga aspektet e gjërave të rëndësishme dhe kurioze, posaçërisht informatat për vendlindjen në Isfahan janë të rëndësishme dhe ju ka kushtuar rëndësi të madhe.

Ibn Rosta deklaroi që përderisa bënte përshkrimin dhe studimin për vende tjera, ai varej nga burimet dytësore të informatave, të cilat shpesh gjendeshin me vështirësi të mëdha dhe kishte pak mënyra për ti verifikuar vërtetësinë e tyre. Sa i përket Isfahanit, Ibn Rosta ka mundur të përdorte përvojën e tij dhe vërtetimet ose deklaratat të cilat kanë qenë të besueshme. Kështu që kemi përshkrimin e njëzet regjioneve (rostāqs) të Isfahan ku përmban detaje që nuk gjenden në punime të gjeografëve tjerë. Nëse flasim për qytetin (Isfahanin), ne mund të mësojmë që ishte në një gjendje rrethi me perimetër prej 10 km, murrët të mbrojtura nga qindra kulla dhe katër porta.

Informatat e tij për njerëzit jo Islam të Evropës dhe Azisë së Brendshme – Qendrore, bëjnë burim të dobishëm (për muslimanët) për këto regjione të panjohura (ai kishte dijeni edhe për ekzistencën e Ujdhesave Britaneze dhe të Hipetarkisë Anglo – Saksone Angleze dhe deri tek Turqit parahistorik, si dhe njerëzve tjerë të stepave. Përshkrimi që Ibn Rosta i bënte Kostandinopojës, është marrë nga një i burgosur musliman që ishte i burgosur në Kostandinopoje, i quajtur Harun b. Yahya, është dëshmuar të jetë shumë i vlefshëm për dijetarët Bizantin.

Burimet

<http://www.iranicaonline.org/articles/ebn-rosta>,

https://en.wikipedia.org/wiki/Ahmad_ibn_Rustah

25 premtime nga

Allahu

Duhet të kuptohet mirë se kur Allahu premtan diçka, atëherë Ai e mendon atë, siç thotë :

“Ky është premtimi i Allahut; Allahu nuk e shkel premtimin e Vet” (Ez-Zumer, 39: 20), dhe në një ajet tjetër, “Premtimi i Allahut është i vërtetë; Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.” (Lukman, 31: 9)

• XHENNETI •

“Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, gëzoji me kopshte të Xhenetit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Sa herë që atyre t’u jepet si ushqim ndonjë frut i kopshteve, ata do të thonë: “Këtë e kemi ngrënë edhe përpara”. Por atyre do t’u jepen vetëm fruta të ngjashme me ato të Tokës. Në Xhenet ata do të kenë bashkëshorte të pastra dhe atje do të jetojnë përgjithmonë.” (Bekare, 2: 25)

• DRITË •

“ditën që do të shohësh besimtarët dhe besimtaret, me dritën e tyre që shkëlqen para dhe në të djathtë të tyre (e do t’u thuhet): “Lajm i mirë sot për ju: kopshtet e Xhenetit nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të banoni përgjithmonë. Kjo është fitorja më e madhe!” (El-Hadid, 57, 12)

• ALLAHU DO TË JETË ME TY •

“Nëse ktheheni (në luftë), edhe Ne do të kthehemi (në ndihmë të besimtarëve). Forcat tuaja nuk do t’ju bëjnë asnjë dobi, sado të jenë të shumta në numër, sepse Allahu është me besimtarët.” (El-Enfal, 8: 19)
“Allahu ua shton udhëzimin atyre, që janë në rrugë të drejtë.” (Merjem, 19: 76)

• MIRËSIA E ALLAHUT •

“Vërtet Allahu e plotësoi premtimin e Vet, kur ju me vullnetin e Tij e thyet armikun. Por, kur ju u frikësuat, u grindët midis jush dhe kundërshtuat (Përgamberin, a.s.), pasi Ai ju tregoi atë që pëlqenit, (Allahu e tërhoqi ndihmën e Vet). Disa nga ju dëshirojnë këtë botë, ndërsa të tjerë nga ju dëshirojnë botën tjetër. Pastaj Ai, për t’ju provuar, bëri që të zmbropseni para armikut dhe pastaj, sigurisht që jua fali atë gabim. Allahu ka mirësi të madhe për besimtarët.” (Al-Imran, 3: 152)

• MBROTJE NGA ALLAHU •

“Pa dyshim, njerëzit më të afërt me Ibrahimin janë ata që e pasuan atë dhe ky Profet me besimtarët (e tij). Allahu është mbrojtës i besimtarëve.” (Al-Imran, 3: 68)

• MËSHIRA E ALLAHUT •

“Përsa u përket atyre që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, ata do t’i pranojë Zoti i tyre në mëshirën e Vet. Kjo është fitorja e lavdishme!” (El-Xhathije, 45: 30)

• FITORE •

“Sigurisht, Ne do t’i ndihmojmë të dërguarit Tanë dhe besimtarët, si në jetën e kësaj bote, ashtu edhe në Ditën, kur do të sillen dëshmitarët.” (El-Gafir, 40: 51), “...Është detyra Jonë që t’i ndihmojmë besimtarët.” (Er-Rum, 30: 47)

• ALLAHU DO T'I SHLYEJË TË KQIJAT •

“Atyre, që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, me siguri që do t’ua shlyejmë të këqijat dhe do t’u japim shpërblim më të mirë se puna që kanë bërë.”

(El-Ankebut, 29: 7)

• DASHURI MES BESIMTARËVE •

“Në të vërtetë, atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i Gjithëmëshirshmi do t’u dhurojë dashuri (në zemrat e besimtarëve).

(Merjem, 19: 96)

• ASNJË MUND NUK SHKON KOT •

“Sa për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, sigurisht që Ne nuk do t’ua humbim shpërblimin punë mirëve.”

(El-Kehf, 18: 30)

• MBROTJE PREJ SHEJTANIT •

“Sepse, në të vërtetë, nuk ka kurrfarë pushteti mbi ata që besojnë dhe mbështeten tek Zoti i tyre.”

(En-Nahl, 16: 99)

“A nuk e sheh se Ne i kemi dërguar djajtë te mohuesit, për t’i yshtur ata me forcë?”

(Merjem, 19: 83)

• ALLAHU TË JEP QËNDRUESHMËRI •

“Prandaj (O Muhamed) qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar.”

(Hud, 11: 112)

“Allahu i forcon besimtarët me fjalë të qëndrueshme në këtë botë dhe në botën tjetër, kurse keqbërësit i shpie në humbje; Allahu bën ç’të dojë”

(Ibrahim, 14: 27)

• PËRFUNDIM TË MIRË •

“Për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira ka çdo mirësi dhe vendbanim të mrekullueshëm!” (Er-R’ad, 13: 29) “...sepse toka është e Allahut. Ai ia jep atë trashëgim cilit të dojë prej robërve të Vet. Fundi i lumtur u takon atyre që i frikësohen Allahut”

(El-A’raf, 7: 128)

• ALLAHU TË SHPËTON •

“Pastaj, Ne do t’i shpëtojmë të dërguarit Tanë dhe ata që kanë besuar. Kështu, është detyra Jonë që t’i shpëtojmë besimtarët.”

(Junus, 10: 103)

“Kështu, Ne i shpëtojmë besimtarët.”

(El-Enbija, 21: 88)

• UDHËZIM •

“Vërtet, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Zoti i tyre do t’i udhëzojë në rrugë të drejtë”

(Junus, 10: 9)

• BEKIME •


“Sikur banorët e atyre qyteteve të besonin dhe të ruheshin prej gjynaheve, Ne do t’u dërgonim bekime nga qielli dhe toka, por ata mohuan, prandaj i dënuam për atë që bënë.”

(El-A’raf, 7: 96)

• PAQE DHE SIGURI •

“Sa për ata që besojnë dhe nuk e molepsin besimin e tyre me padrejtësi (idhujtari), pikërisht atyre u takon siguria dhe ata janë të udhëzuar.”

(El-En’am, 6: 82)





• FALJE •

“Allahu u ka premtuar falje (të gjynaheve) dhe shpërblim të madh atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira.” (El-Ma’ide, 5: 9)

• SHPËRBLIME NGA ALLAHU •

“Ndërsa atyre që besojnë dhe punojnë vepra të mira, Zoti do t’u japë shpërblimin e merituar. Allahu nuk i do punëmbropshtët” (Al-Imran, 3: 57)

• S’KA FRIKË E PIKËLLIM •

“Ata që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, falin namazin dhe japin zeqatin, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre dhe nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen.” (Bekare, 2: 277)

• ALLAHU I MBRON BESIMTARËT •

Allahu, në të vërtetë, i mbron besimtarët. Ai nuk i do tradhtarët mohues.” (El-Haxh, 22: 38)

• JETË TË MIRË •

“Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë.” (En-Nahl, 16: 97)

“Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime (nuk i beson këtij Kur’ani dhe nuk vepron sipas udhëzimeve që ka), do të ketë jetë të mjeruar ...” (Ta-Ha, 20: 124)

• AUTORITET-UDHËHEQJE •

“Allahu u ka premtuar atyre prej jush, që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t’i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu si i ka bërë ata para tyre dhe që do t’ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe që frikën do t’ua shndërrojë në siguri. Le të më adhurojnë Mua e të mos Më shoqërojnë asgjë (në adhurim). Sa për ata që, pas kësaj, mohojnë (besimin), pikërisht ata janë të mbrapshtët”.

(En-Nur, 24: 55)

• ALLAHU NUK LËJON QË JOBESIMTARËT T’I SHKATËRROJNË BESIMTARËT •

“Allahu nuk do t’iu japë kurrë rast mohuesve që t’ishkatërrojnë besimtarët.” (En-Nisa, 4: 141)

• NXJERRJA NGA ERRËSIRA NË DRITË •

“Allahu është Mbrojtësi i atyre që besojnë. Ai i nxjerr ata nga errësira në dritë. Sa për ata që nuk besojnë, mbrojtësi i tyre është djalli, i cili i nxjerr ata nga drita dhe i shpie në errësirë. Këta janë banorët e Zjarrit (të Xhehenemit), ku do të qëndrojnë përgjithmonë.” (Bekare, 2: 257)




Anketa e Vlera-së për Muajin Ramazan

Prej kur e agjëroni ramazanin, a hasni në vështirësi? A ju kap etja o uria shpesh e shumë, a e shoqëroni me namaz agjërimin, në shtëpi apo në xhami?

Mehmet Rama

Agjërimin dhe namazin kam filluar qysh herët, i vogël, dhe prej atëherë e deri më sot në moshën 85 vjeç, kam agjëruar e vazhdoj ta agjëroj, në rini e kam pasur shumë lehtë, ndërsa tani që jam plakur pak ma zor, por nuk po dorëzohem dhe pse kur ka qëlluar ramazani në ditët e nxehta ka qenë jo lehtë, kjo sepse unë punoj bahqen e më ka takuar që të duroj temperatura të larta, po Zoti më ka dhënë fuqi që të mos ta prish agjërimin, më herët shkoja i falja teravitë në xhami, ndërsa tani nuk mundem të eci, sepse dhe xhamija gjendet 3km larg nga shpija ime, në xhami shkoj të falem vetëm të xhumave, kurse 5 kohët e namazit i kryej në shtëpi.



Elmaze Latifi

Fillimisht unë kam agjëruar ramazanin në moshën 18 vjeçe, ngase namazin nuk dija ta falja, dhe thënë drejtën e ndjeja agjërimin të mangët pa namaz, por vazhdimisht i lutesha Zotit që të mos ndaloj frymën, të mos ma marrë shpirtin pa e vënë ballin në sexhde, dmth pa e falur namazin dhe Zoti shumë shpejt ma plotësoi ëndrrën, dëshirën e kamotshme për t'iu përkulur Atij dhe bërë dua në sexhde. Gjithmonë përpiqem që të jem shumë e devotshme me veten, njerëzit, Zotin. Agjërimin e kam pasur gjithnjë të lehtë, pothuajse, rrallëherë a hiç më ka ndodhur që të ik nga mendja se jam duke agjëruar e të ngrënë diçka. E fali namazin dhe përgjatë muajit të shenjtë gjithashtu. Në xhami shkoj ndonjëherë sepse nuk kam me kënd dhe xhamin e kam jo afër shtëpisë.



Sara Beka

Unë kam filluar të agjëroj prej moshës 14 vjeçe, në fillim e kam pasur jo të lehtë, e mbaj mend se agjëroja një ditë po, tjetrën jo, pra me ndërprerje ngaqë nuk duroja pa ngrënë o pirë. Po mandej duke e praktikuar kështu, e kisha shumë të lehtë, agjëroj për shpirtin tim në mënyrë që Zoti të më mëshirojë, e të mos më ndëshkoj për gabimet pa vedije o me vedije të cilat i kam bërë. Përgjatë agjërimin, në ditët e gjata të ramazanit më ndodh që të habitem keq duke pirë një gllënjë ujë, o duke futur diçka prej ushqimeve në gojë, por në atë moment e kuptoj se jam duke agjëruar dhe e ndërpres sigurisht. Shkoj në xhami me shoqe, për të falur teravitë zakonisht.



Egëziona Rama

Agjërimin e kemi obligim nga Zoti, mirëpo unë nuk agjëroj vetëm përgjatë muajit të shenjtë, por dhe muajve tjerë, ditëve tjera, të hënave dhe enjteve, zakonisht. Kam filluar të agjëroj qysh 13 vjeçe, e mbaj mend agjëroja vetëm 10 ditë afërsisht të muajit të madhërishtë, sepse nuk e duroja etjen, urinë, e herë habitesha e ushqehesha o pija. Prej moshës 16 vjeçe vazhdoj agjëroj pa ndonjë vështirësi, gjithashtu edhe fal namazin, vetëm në shtëpi, pas iftarit deri në syfyr qëndroj zgjuar duke pritur e përgatitur atë.

përurohet "Qendra e Grave Amel"



Në një rrugë të Dorchester të mbushur me shtëpia trekatëshe, një shtëpi e gjelbër me një portë të bukur ngjyrë vjollce qëndron bukur **"Qendra e Grave Amal"** ku shkruan se është e hapur për të gjitha gratë dhe fëmijët që kanë nevojë për të.

Sipas Malika MacDonald-Rushdan, drejtore-
sha e zyrës së terrenit të organizatës së shërbi-
meve sociale myslimane, ICNA Relief ajo tregon
se ne: "Ne shpresojmë të lehtësojmë kalimin e
grave dhe fëmijëve nga një situatë në situata
të ndryshme të mjerueshme, prandaj duke e
hapur kërë shtëpi shprese në qytetin tonë, ne
shënojmë strehimin e parë tranzicional të dre-
jtuar nga myslimanët në Masachusetts,

Këtu në qendrën "**Qendrën e Grave Amal**" bëhet përkrahja dhe mbështetja me mjetet që ato kanë nevojë për të qenë të vetëmbajtura dhe për të kaluar sfidat me lehtësi. Ndihma në qendër përfshin udhëzimin e tyre për të referuar programe që mësojnë gjuhën angleze si gjuhë të dytë dhe të tjerët që ofrojnë klasa për të fituar një shkallë të barabartë të shkollës së mesme.

Punonjësit e qendrës gjithashtu ofrojnë asistencë me trajnimin e aftësive dhe aplikimet për punë. Amal do të thotë "shpresë" në arabisht, shpjegoi MacDonald-Rushdan. Ngjyra e gjallë vjollce e derës nënkupton atë ndjenjë. Shtëpia e vogël në tranzicion hapi dyert e saj më 17 prill 2017 dhe deri tani i kemi strehuar e trajnuar një

numër të mëdha të grave dhe tani momentalisht i kemi 12 shtretër të zënë që së shpejti do ti aftësojmë të lehtësojmë jetën që të mund të jetojnë vetë pa ndihmën e qendres.

Për të përruar hapjen e kësaj qendre kryebashkiaku i Bostonit Marty Walsh do të marrë pjesë në një prerje të shiritit dhe hapje solemne.

Walsh dhe zyrtarë të tjerë të qytetit kanë qenë veçanërisht mbështetës të qendrës, tha ajo. Kryetari i bashkisë ka qenë gjithashtu i sigurt për të siguruar që Boston është një qytet shenjtëror, i cili duhet të mbrojë dhe të mirëpresë njerëzit nga të gjitha vendet dhe besimet.

Përveq fotos së Malcolm X në muret tona ne gjithashtu kemi respekt të madh edhe ndaj ministrit Louis Farrakhan, udhëheqës i diskutueshëm i Kombit Islam, prandaj në muret tona gjithashtu do të varen edhe fotot e tija si shejë kjtimi dhe sacrifice që ata kanë bërë për njëërzinë.


Kuzhina e qendrës muslimane ndjek metodat e përgatitjes së ushqimit Halal, por MacDonald-Rushdan tha se objekti ishte i mirëseardhur për të gjithë, që do të thotë të ndihmojë çdo grua që ka nevojë për të, pa marrë parasysh besimin e saj.

"Mjedisi në disa strehimore - jo vetëm për një grua muslimane, por për gratë në përgjithësi - nganjëherë mjedisi nuk është më i miri", tha MacDonald-Rushdan. "Dhe ne duam t'u japim atyre një vend të sigurt ku ato ndjehen të respektuara, ku ne ruajmë dinjitetin e tyre, të cilat shpesh herë mendoj se mungojnë në strehimoret e tjera sot".

Përgatiti. Valdrin Fashari

*"Fqinji ynë, (ku-
jtoi Malcolm X-in
) i cili kishte banu-
ar në këtë lagje dhe
kishte ecur këtyre
rrugëve, do të ishte
shumë i kënaqur dhe
i gëzuar me këtë
aktivitet tonin,
prandaj ne kemi
vendosur që në
muret e Qendres
sonë ta kemi edhe
foton e të nderuarit
Malcom X*

tha MacDonald-Rushdan.



Sexhdeja e Ademit

paqja qoftë mbi të.

“Sexhdeja është manifestim praktik i parimit të përcaktimit të Zotit që Ademi është më i madh dhe se ka njohuri të cilën nuk e kanë melekët.”

Sexhde është çdo akt i cili ia tregon Zotit hyjninë e Tij dhe përlësinë tonë para tij. Të rënit me fytyrë përtokë, kryerja e ruku-së (prëulja), krejt kjo konsiderohet si ibadet (vepër adhurimi) Sa më e madhe është përlësia në kryerjen e sexhdes, edhe ibadeti konsiderohet më i madh. Sexhdeja është dëshmi se ai që e kryen veten e konsideron më të ulët në raport me Zotin e vet dhe shpreh përlësinë më të sinqertë. Dhe prandaj njeriu gjatë sexhdes e lëshon fytyrën të tokë nga përlësia ndaj Zotit.

Që epërsia e njeriut ndaj melekëve të theksohet edhe më shumë, Allahu u urdhëron që ato t'i bëjnë sexhde njeriut. Çka është sexhdeja? Kjo është ajo çka kanë “në mend” melekët dhe çka duhet të zbatojnë në praktikë. Madje edhe nëse ka pasur ndonjë protestë ose rebelim të melekëve në

lidhje me rolin e Ademit, me këtë sexhde kjo është shlyer. Kështu ata edhe me vepër e pranuar inferioritetin e tyre ndaj Allahut.

Këtu duhet theksuar dy gjëra:

1. Sexhdeja nuk është bërë ndaj Ademit si njeri, porse si simbol të gjithë neve, njerëzimit. Përse sexhde pikërisht për të? ngase ai ka qenë njeriu i parë i ploti cili manifeston insanin në kuptimin e plotë. Kur vini në operacion, nuk i dorëzoheni një personi, porse titullit të tij të doktorit, sepse ajo shpreh dituri dhe bën që ju të kini besim në aftësinë e tij. Nuk sillemi për qark Qabes vetëm sepse është një gur, por ngase është simbol i bashkimit me Krijuesin.

Si mund t'i përgjigjemi dikujt që na pyet: **“Si i kanë bërë melekut sexhde bijve të Ademit, kur në Kur'an thuhet qa-**

rtë se melekët i bëjnë sexhde Ademit (Usx-hudu li Ademe)? Si mund t'i bindim që kjo sexhde ka të bëjë me neve?

Vetë Kur'ani na sjell argument që kjo sexhde ka të bëjë me bijtë e Ademit, dhe jo vetëm me Ademin. Kur trajtohet çështja e hilafetit të njeriut në tokë, kjo gjithsesi nuk ka të bëjë vetëm me Ademin, a.s. Është e qartë se mendohet për bijtë e Ademit. Është dëshmuar edhe se do të ekzistojnë pasardhësit e tij të cilët do të jenë më lartë se vetë ai, njëri prej tyre është edhe Muhamedi, s.a.a.

Ademi paraqet edhe kalifin në tokë, por nuk

është vetëm ai kalif. E shohim sa i vlerësuar është ky funksion kur i bëhet sexhde Adem-it dhe, njëkohësisht, mbarë njerëzimit.

2. Iblisi, i cili refuzoi t'i bënte sexhde njeriut dhe u rebelua për shkak të prioritetit të cilën e kishte marrë njeriu (Ademi), thotë se pasardhësit e Ademit do t'i devijojë deri Ditën e gjykimit. Edhe këtu mund të shohim që sexhdeja të cilën melekut ia bënë Ademit ka të bëjë me mbarë njerëzimin,. Dhe jo vetëm me Ademin.

Ai tha: **“Pasha madhërinë Tënde, kam për t'i shmangur nga rruga e drejtë të gjithë, përveç atyre robërve Tu që janë të singertë!”** (Sad, 82-83)

(Iblisi) Tha:

“Zoti im – tha (Iblisi) – për shkak se më largove, unë do t'ua zbukuroj të këqijat atyre në tokë (në këtë botë) dhe të mundohem të gjithë t'i largoj nga rruga e drejtë!”

(El-Hixhr, 39)

Sikur sexhdeja t'i ishte bërë vetëm Ademit, Iblisi, i zemëruar për këtë, nuk do t'i hakmerrej të gjithë neve, pro vetëm Ademit. Sexhdeja është manifestim praktik i parimit të përcaktimit të Zotit që Ademi është më i madh dhe se

ka njohuri të cilën nuk e kanë melekët. Vepra është produkt final i ideve të njeriut dhe ahkalut të tij. Melekët me sexhde kanë dëshmuar ‘ka në “mendjet” e tyre. Për shembull, kur dy njerëz pas grindjes përqafohen, vetë akti i përqaimit është konfirmim praktik i atij pajtimi i cili ndodhet në kokat e tyre.

Prof.dr. Eidi Ekber.



“Vepra është produkt final i ideve të njeriut dhe sjelljes së tij.”

ROGER WATERS KA HUMBUR MILIONA DUKE I QËNDRUAR NË KRAH PALESTINËS

"NËSE ATA THONË DIÇKA NË PUBLIK ATA NUK DO TË KENË MË NJË KARRIERË. ATA DO TË SHKATËRROHEN. UNË SHPRESOJ QË T'I INKURAJOJ DISA PREJ TYRE QË TË MOS KENË FRIKË DHE TË NGREHIN ZËRIN E TYRE, SEPSE NE KEMI NEVOJË PËR TA.."

Një çështje që ai ka plotësisht të drejtë është çështja e vuajtjes palestineze në duart e luftës izraelite, okupimit dhe bllokadës ekonomike. Për më shumë se dhjetë vjet, Waters është marrë me çështjen e lirisë palestineze dhe pikë qendrore në muzikën e tij dhe shfaqje dramatike në skena te ndryshme ishte kryesisht çështja për lirinë e Palestinës.

Waters është pjesë e lëvizjes Boycott-Divestment-Sanctions që të inkurajoj individët që të bojkotojnë produktet izraelite dhe turizmin. Waters përdor statusin e tij si një 'legjendë muzikore' për të nxjerrë në pah gjendjen e palestinezëve. Në vitin 2012 ai foli në Kombet e Bashkuara për këtë çështje. Ai shpesh shkruan letra të hapura për muzikantët e tjerë duke u kërkuar atyre që të zbrapsen nga performimi në Izrael derisa të arrihet një zgjidhje kuptimplotë e paqes.


Waters është një shembull i përsosur se si kompleksi industrial-medial ndëshkon individët që nuk i përshtaten stereotipit të një yllit veteran të rokut.

Në fund të vitit të kaluar, një tregim i nënpërfaqësuar ka sqaruar se si American Express hodhi poshtë një marrëveshje të planifikuar të sponsorizimit të Waters-it për turneun e tij në vitin 2017, që u tha se ishte me vlerë 4 milionë dollarëshe.

Ka shumë të famshëm që përdorin shkaqe politike për të rritur statusin e tyre, ne nuk shohim asnjë dëshmi që Waters ka përfituar nga çështja për lirinë e Palestinës. **Përkundrazi është e vërtetë. Duket se mesazhi i tij i paqes për të gjithë dhe urrejtja për askënd atij i ka kushtuar miliona dollar.**

WATERS PËRSHKROI SITUATËN NË INDUSTRIJË
E TIJ TË MUZIKËS ME RRESHTAT NË VAZHDIM:

"INDUSTRIA IME KA QENË VEÇANËRISHT E PABINDUR NË NGRITJEN E NJË ZËRI (KUNDËR IZRAELIT). UNË DHE ELVIS COSTELLO, BRIAN ENO DHE NJË OSE DY TË TJERË, POR ASNJËRI PREJ TYRE NUK ËSHTË NË SHTETET E BASHKUARA KU JETOJ UNË. UNË KAM BISEDUAR ME SHUMË PREJ TYRE, DHE ATA JANË TË PAKËNAQUR POR EDHE TË FRIKËSUAR QË TË FLASIN.



Fakti është se shumica e muzikantëve nuk fitojnë as humbin shumicën e fansave për shkak të politikës. Fakti është se shumica e njerëzve blejnë albume dhe bileta të koncerteve bazuar në faktin se ata pëlqejnë zërin e tij ose një kënge ose kënaqen duke kënduar së bashku me tekstet e tyre.

Nëse Waters po mbron për gjenocid, mizori, urrejtje apo imperializëm, nuk do të pajtohem që koncertet e tij duhet të bojkotohen. Por fakti që ai po mbron për pikërisht të kundërtën e gjërave të lartpërmendura, e bën në pozitë American Express të duket jo vetëm ekstrem, por edhe jo logjik.

Roger Waters është duke u dënuar për fjalim e tij të lirë në një temë që nuk duhet të jetë e diskutueshme. Fakti që disa e gjejnë të diskutueshme tregojnë se sa të ulët dhe të egër janë bërë natyra e debateve moderne për të drejtat e njeriut. Asnjë popull i pafajshëm nuk

meriton të jetë i shtypur dhe i okupuar, por pikërisht kjo po ndodh me palestinezët dhe kjo ka ndodhur me dekada.

Si dikush që ka parë fjalimet e Waters shumë herë, unë e rekomandoj ata, madje edhe për ata që nuk pajtohen me pikëpamjet e tij, por që duhet ta shijojnë përballjen me të.

Marrur nga : www.theduran.com

Përkthyer V. J



Kerameti

DHE

Fadileti

Njerëzimi në vete ka keramete dhe fadilete. Kemi thënë që kerameti është karakteristik vetëm për një person, kurse fadileti është karakteristik për grupe. Nëse njerëzit kanë keramete, por nuk kanë llojet tjera, fadilete kanë edhe të tjerët. Atë që e ka njeriu ai kerameti cili i ndan njerëzit nga llojet tjera është akl (mendja) i tij dhe aftësia e lartësimit shpirtëror. Lavdiploti i dhuroi njeriut mendjen dhe falë saj ai është në gjendje të arrijë përsosmërinë. Asnjë krijesë tjetër nuk është në gjendje ta arrijë.

Melekët kanë akl, por nuk kanë udhëtime deri te përsosmëria e fundit. Siç janë krijuar, nuk u shtohet, as u pakësohet intelektualiteti, edhe shtazët janë njëloj siç janë krijuar, nuk i ndryshon as karakteri as sjellja. Bleta prej 5 milion vjetësh jeton njësoj, bën mjalte dhe hoje gjashtëkëndëshe, njësoj si sot. Nëse njeriu lind në një qytet dhe largohet, pastaj kthehet pas 50 vjetësh, më nuk do të njohë asgjë. Prandaj, njeriu ka akl, një fuqi inicuese e cila i mundëson të ngrihet.

Sa i përket fadiletit, atë e kanë edhe njerëzit edhe shtazët. Njerëzit vishen, edhe shtazët kanë gëzof, njerëzit kanë banesa, edhe shtazët janë strofkat e veta, edhe njerëzit edhe shtazët kanë pasione. Krejt është njësoj dallojnë vetëm në kualitet. Shtaza gjithë jetën ha ushqim të njëtra-

jtshëm (p.sh. vjedulla - misër), kurse njeriu për ditë diç tjetër. Njësoj është edhe kur është fjala për veshjen: ariu gjithnjë bartë një gëzof, kurse njerëzit? Ariu jeton gjithnjë në strofkën e vet, kurse njerëzit, natyrisht, ndërrojnë vendbanimin sipas nevojës. Edhe kur është fjala për pasionet e shtazëve dhe njerëzve, ka dallime.

Në konflikt me armikun shtazët kanë teknikë të thjeshtë, kurse ne kemi çdo ditë një teknologji të re të luftës. Falë diturisë njeriu çdo ditë mposht pengesa dhe rreziqe në rrugën e vet (mëson teknologji për kundërvënje ndaj përmbytjeve, tërmete dhe sëmurjeve). Njeriu është në gjendje ta kuptojë të vërtetën, ekzistuesen dhe të paqenën. Ekzistojnë mendja e zakonshme dhe spekulative (filozofike). Me logjikë të zakonshme njeriu zgjidh problemet e kësaj toke, kurse me logjikë filozofike – problemet filozofike.

Përgaditur nga Redaksia VLERA

10 GJËRAT TË CILAT DUHET T'I BRAKTISNI NGA JETA E JUAJ

1. BRAKTISE ATË QË E URREN,
FOKUSOHU NË ATË QË E DON.
2. BRAKTISE TË KALUARËN,
MBAJE LEKSIONIN.
3. BRAKTISE IDENË SE KE NEVOJË
QË TË BËHESH I PËRKRYER
4. BRAKTISE IDENË E SË KËNAQURI TË TJERËVE.
5. BRAKTISE KOMUNIKIMIN NEGATIV
ME VETVETEN.
6. BRAKTISI THASHETHEMET
DHE PARAGJYKIMET.
7. BRAKTISI PERSONAT TË CILËT
TË NËNVLERËSOJNË.
8. BRAKTISE SHPËRTHIMIN ZEMËRUES.
PAQJA ËSHTË FUQI.
9. BRAKTISE IDENË E KRAHASUARIT
TË VETËS TËNDE ME TJERËT.
10. BRAKTISE KEQARDHJEN,
ÇDO GJË NDODH PËR NJË ARSYE

ÇFARË NGJYRE KA AURA JUAJ?

Aura është një burim i energjisë që e rrethon trupin e një personi përgjatë gjithë kohës varësisht nga përvoja dhe rrethanat nga secili individ. Shkurtimisht, në esencë të njeriut ekziston kjo aurë dhe mund të kapet duke përdorur diçka të quajtur fotografija Kirlian ose elektrografia. Ndërsa shumë njerëz e konsiderojnë studimin e Auras si pseudo-shkencore dhe e pabazuar, ky vazhdon të jetë një aktivitet shumë i popullarizuar dhe mund të ju ndihmojë juve që të kuptoni pikat e forta dhe dobësitë tuaja në fushën energjetike.

ANDAJ, ÇFARË NGJYRE KA AURA JUAJ, DHE ÇFARË NËNKUPTON AJO?

E VERDHE

Tiparet kryesore e atyre të cilët mbizotërojnë aurën me ngjyrë të verdhë janë inteligjent, logjik dhe mendje shpejtë. Ata mendojnë me kokën e tyre, jo me zemrën e tyre, dhe mund të lënë mënjanë emocionet e tyre dhe të merren me problemet të cilat lindin. Ata nganjëherë mund të punojnë vështirë, pasi që ata lulëzojnë kur mbërrijnë qëllimet e tyre. Personat me aura të verdhë preferojnë ta kalojnë kohën vetëm, megjithëse nuk ndjehen të vetmuar. Ata nuk kanë shumë miq sepse ata i përzgjedhin me mençuri, por ata i duan dhe i admirojnë miqtë e ngushtë të miqve. Personat me aurë të verdhë dëshirojnë muhabetë shumë inteligjente, ata nuk i duan bisedat e vogla të pakuptimta. Dobësia kryesore e këtyre personave është nganjëherë mund të jenë shumë gjykues për vetën dhe tjerët.

E KUQE

Siç keni menduar, personat me aura të kuqe posedojnë zjarrësi, natyrë të zjarrtë dhe nuk mund të zbuten lehtë. Ata e duan lirin, aventurë, dhe ekspertimin, dhe mërzhiten shpejt. Personat me aura të kuqe kanë një nivel të lartë të besimit në të gjitha fushat e jetës dhe normalisht nuk vuajnë nga sëmundjet mentale o fizike. Ata i duan sportet dhe të bërit e aktiviteteve dhe kanë një natyrë të lartë konkurruese. Ata janë udhëheqës të lindur dhe nuk pëlqejnë që tjerët

tu tregojnë se çfarë duhet të bëjnë. Ata janë të hapur, të singertë, dhe nuk fshehin asgjë nga ju. Ata janë të drejtpërdrejtë. E vetmja dobësi e personave me aura të kuqe është se nevoja e tyre për tu ngritur në krye mund të djegë disa ura në rrugët e tyre.

ROZË

Personat me aura pink kanë bujari, ëmbëlsi, dhe energji të afrueshme dhe japin dashuri lirshëm dhe janë romantik të pashpresë. Ata gjithashtu janë empatik, me një aftësi të çuditshme psikike me kreativitet të talentuar. Personat me këtë ngjyrë të aurës janë idealist, gjë që e bën të vështirë që ta shohin botë ashtu siq është. Ata duan që ta ndryshojnë atë disi, dhe konsiderojnë që misioni i tyre në jetë është që ta bëjnë këtë. Ashtu sikur personat me aura të kuqe dhe njerëzit me aura pink janë shumë të singertë, dhe i japin çdokujt një shans të drejtë. Sidoqoftë ata duhet të mësojnë që të ngriten për vetën e tyre, sepse njerëzit kanë prirje të ecin përmbi ta përshkak të natyrës së butë.

E GJELBËRT

Nëse ti ke një aura të gjelbërt, atëherë ju keni një dashuri të patundur për jashtë dhe e konsideroni vetën një dashurues të natyrës. Ti poash-tu me gjasë ke një nivel të lartë të vetëdijes njerëzore dhe ushqehesh vetëm me ushqime të shëndetshme. Ti i mban këmbë vendosur në tokë dhe nuk sinokrozoni me idealet në qiell. Ju keni një qasje praktike, reale në jetë dhe mbani kujdes për vetën dhe shtëpinë që ta mbani të lëmuar e të pastër. Ju gjithashtu gëzoni siguri dhe stabilitet, dhe nuk u pëlqen që të ju ndodhin shumë ndryshime në jetën tuaj. Sidoqoftë, nganjëherë bëheni i ngurtë ndaj qasjes së jetës, kështu që përpiku që tu ec më rrjedhshëm.

VJOLLÇË

Kjo ngjyrë nënkupton aftësi të mëdha psikike dhe ndjeshmëri të lartë ndaj emocioneve dhe energjive. Njerëzit me ngjyrë të aurës purple janë misterioz, me natyrë të qetë dhe mendojnë në të gjitha pyetjet e mëdha të jetës. Ata kurrë nuk pushojnë së eksploruari, dhe duan që të mësojnë për tema të reja. Ata jetojnë shumë

brenda mendjeve të tyre, por ata kanë shpirt të bukur. Personat me ngjyrë të tillë tentojnë të kalojnë një pjesë të kohës në natyrë dhe me kafshët e tjera, pasi që ata ndjehen të keqkuptuar nga shumica e njerëzve. Ata nuk kanë shumë miq, por ata i admirojnë dhe i çmojnë ata të cilët i kanë. Nganjëherë, njerëzit përfitojnë nga natyra e hapur e tyre, nga natyra e dashur, kështu njerëzit me këtë aura kanë nevojë të bëjnë më shumë vetkujdesje që të mbrojnë energjin e tyre

E KALTERA

Të poseduarit e një ngjyre të tillë është mjaft e rrallë, por kjo simbolizon forcën në komunikim dhe personalitet të fuqishëm. Siç mund të keni supozuar, kjo aura nënkupton një natyrë të qetë dhe të butë, dhe kështu këta njerëz janë paqebërës dhe zgjidhës së problemeve. Ata mund t'i qetësojnë gjërat shpejt me një argument, dhe kanë një mënyrë të singertë, të drejtë dhe elokuent për të komunikuar me njerëzit. Këta njerëz kanë një balance të përsosur të menduarit dhe të ndjenjave, dhe gjithmonë e thonë të drejtën në kohë të duhur. Megjithatë, ata nganjëherë mund të kalojnë shumë kohë në punë dhe të gjejnë kohë të mjaftueshme për lidhjet e tyre.

ARI

Personat me aura ngjyrë ari ushqejnë dashuri për të gjitha gjërat e bukura dhe elegante të jetës. Ata lulëzojnë duke qenë në qendër të vëmendjes, dhe kanë jetë shoqërore aktive. Ata janë mikpritës, argëtojnë njerëzit, dhe u pëlqejnë që të kërkojnë ndihmë o kasha nga tjerët. Këta njerëz nganjëherë mund të vijnë si të cekët përshkak të shijeve të tyre ekstavagante, por ata thjesht gëzohen duke u dhuruar njerëzve gjëra të mira, dhe duke dekoruar hapësirën e jetës me ta.


BARDHE ARGJENDI

Shumë të talentuar dhe fleksibil në të gjitha fushat e jetës, njeriu me këtë aura mund të përshtat përshtatshmërisë çdo situatë. Është pothuajse njëjtë sikur ata që të formojnë vetë në çfarëdo që kanë nevojë të bëhen, dhe ata shkëlqejnë në arena të ndryshme të jetës. Ata tërheqin suksese

sin në të majtë dhe në të djathtë, dhe zakonisht bëhen udhëheqës dhe mësues të mire. Njerëzit janë të tërhequr prej tyre përshkak të bukurisë së brendshme dhe të jashtme, por personat me të tillë aura kanë nevojë të kenë kujdes që kjo të mos u shkojë në kokë.

E KAFTA

Njerëzit me ngjyrë kafe aure ndiqëse ose të errët kanë tendencë që të bëhen shpirtra të humbur, duke u përpjekur që të gjejnë vendin e tyre në jetë.



Ata mund të bien brenda zakoneve të këqija, dhe kanë një imazh negative për jetën. Ata tentojnë që të fokusohen shumë në të metat e tjerëve, duke harruar t.i adresojnë dhe t.i rregullojnë të tyre.

E ZEZA

Pika të zeza për të bllokuar në fushën energjetike. Kjo gjithashtu mund të nënkuptojë çështje të thella, të pazgjidhura, depresion, zemërim, stagnim, pakënaqësi ose ndonjë emocion tjetër negativ.

SHTËPIA ME VLERA



PROJEKTUES: **ANTOINE MORRIS,
DAVID LONG, MELANIE MORRIS**

SIPËRFAQJA: **327M2**

LOKACIONI: **TORONTO, KANADA**


VITI: **2014**

Një çift i martuar, bleu një shtëpi dy katëshe ne Parkdale, Toronto. Shtëpia më parë ishte e ndarë në tre apartamente që ata deshironin ta shndërronin në një shtëpi të vetme e cila do të akomodonte familjen e tyre të ardhshme. Ata donin të krijonin një hapësirë miqësore dhe të hapur që do t'i lejonte ata të kenë komoditet për familjen dhe miqtë e tyre. Kjo strategji e dizajnit bëri të mundur hapjen e hapësirave të mbyllura kështu që çdo dhomë do të ishte e lidhur me njëra tjetrën.



Një pjesë e madhe e hyrjes së shtëpisë u la e paprekur. Disa riparime të vogla janë bërë me tulla dhe dritare të reja të instaluar duke respektuar karakterin historic të shtëpisë. Interieri është riparuar krejtësisht, kurse në pjesën e jashtme është nxjerur një bodrum i përforcuar. Në pjesën e pasme të shtëpisë është veshur fasada me alumin të zi për t'i dhënë kontrast shtëpisë ekzistuese nga ajo e vjetra. Nga ky mur deri në pjesën e përparme, vazhdon fasada e mbuluar me tulla të kuqe që krijon një pasazh mes shtëpisë së re dhe asaj të vjetër.

Hyrja e shtëpisë na dërgon drejtë në një hapësirë të gjerë të qëndrimit ditor dhe ngrënies që pason me kuzhinën e thellë. Shkallët, të veshura me raft librash nga druri, na çojnë në dhomat familjarë të gjumit dhe banjot. Mbi këto dhoma është një papafingo komode e arritshme me shkallë nga e cila mund të mbikëqyret hapësira më poshtë. Nëpërmjet hapjes në murin me tulla, arrijmë në dhomën e gjumit master e cila ka pamje nga kopshti.



Përgatiti: F.B.



KUSH ËSHTË “WORLD FEDERATION”



Organizata e quajtur “World Federation” apo në shqip “Federata Botërore” me seli në Londër është një dorë e lire për punë të mira si në Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë, në Afrikë, Azi e shumë vende të tjera në botë. Përfaqësuesit e kësaj Organizate janë gjithnjë vigjilent si në tubimin e fondeve humanitare si dhe në shpërndarjen e mirëfilltë të ndihmave material dhe mbështetjeve shpirtërore kudo në botë.

“WORLD FEDERATION” është një OJQ me Status Special Konsultativ me Këshillin Ekonomik dhe Social (ECOSOC) të Kombeve të Bashkuara të Amerikës, punon për të arritur kënaqësinë e Zotit, duke zhvilluar komunitetet pa dallim kombësie dhe feje dhe duke shërbyer njerëzimit me ndihma materiale dhe përkrahje të projekteve që kanë të bëjnë me përmirësimin e jetës në shoqëri.

“WORLD FEDERATION” Federata Botërore, punon ngushtë me partnerët në terren për të ofruar shërbime të tilla dhe shpesh ofron asistencë në fushat e ndryshme të jetës me projektet afat të mesëm dhe të gjatë.



WF-AID

që nga viti 1976, janë përpjekur të jetojnë me moton “Ne ekzistojmë për të shërbyer”. Me ndryshimin e kohës, praktika e WF-AID ka vazhduar pa ndërprerje dhe ka qenë e gatshme tu përgjigjet personave dhe familjeve me nevojë për ekzistencë.

Fillimisht, përpjekjet tona u përqendruan në Lindje, ku ishte më urgjente nevoja për të lehtësuar varfërinë e popullit. Kanë punuar për të ndërtuar komplekset e strehimit, shkollat, xhamitë, sallat

dhe kampet mjekësore për të lejuar njerëzit të arrijnë një ndjenjë të stabilitetit në jetën e tyre.

Në vitet 1980, kur çështja e punësimit të paligjshëm të fëmijëve në Indi nuk kishte marrë vëmendjen e medias, në WF-AID punuam për të liruar fëmijët nga skllavëria e borxheve dhe për të sponsorizuar arsimin e tyre. Gjatë viteve, ne kemi ndihmuar në edukimin e mbi 25,000 fëmijëve në Indi, Pakistan, Kenia, Tajlandë dhe Bangladesh, të cilët janë bërë pionierë të ndryshimit për komunitetet e tyre.



WF-IAD & KOSOVA

Sa i përket popullit të Kosovës World Federation ka përzgjedhur Institutin Kërkimor Ndërkombëtar “Naim Frashëri” i cili posedon Departamentin për Zhvillim Social DZHS, si partner të sigurt dhe si urë lidhëse e shërbimit për t’ia zgjatur dorën e bamirësisë edhe popullit të Kosovës me moton “Ne ekzistojmë që t’ju shërbejmë”

Edhe njëherë përzemërsisht e falënderojmë Organizatën “World Federation” që këtë Ramazan aktivitetin e saj Humanitar e ka shtrirë edhe në Republikën e Kosovës dhe urojmë që fondet e tyre humanitare të begatohen edhe më shumë për të mirën e njerëzimit në botën e mbarë.

Në këtë portal mund të gjeni shumë gjëra interesante, dhe ide se si mundemi të jemi në shërbim të popullit me aq mundësi që kemi. www.wfaid.org gjithashtu edhe këtu mund të njoftoheni me Institutin “Naim Frashëri” në Prishtinë si ndërmjetësues i këtij projekti humanitarë, www.naimfrasheri.net DZHS –Departamenti për Zhvillim Social

Me respekt Redaksia VLERA- Prishtinë



SHTËPIA BOTUESE

DIELLI PAS REVE

Revistën Vlera mund ta gjeni
në të gjitha kiosket e Kosovës.



Të nderuar lexues!

Redaksia mirëpret përgjigjet tuaja për anketën e re të revistës Vlera

- Cili shkrim ju pëlqen më shumë ?
- Çfarë tematikisht mendoni se duhen shtuar në revistë ?
- Cila rubrikë mendoni mund të rrisë numrin e lexuesve të revistës ?

Na shkruani në:

vlera.magazine@gmail.com

RAMADAN RELIEF 2017



WF-AID

ECONOMIC EMPOWERMENT & DISASTER RELIEF

T: +44 (0)20 8954 9881 | E: info@wfaid.org



[worldfedaid](https://www.facebook.com/worldfedaid) | www.wfaid.org